



RAPORT MBI GJETJET E GRUPEVE TË FOKUSUARA

TË ZHVILLUARA NË DHJETOR, 2014

MARS 2015

A solid blue horizontal bar spans the width of the page at the bottom.

Objektivat e Hulumtimit përmes Grupeve të Fokusuara

- Të identifikojë çështjet më me përparësi për qytetarët në mënyrë që të ndihmojë drejtuesit politikë dhe të shoqërisë civile të hartojnë politika që iu përgjigjen shqetësimeve të qytetarëve;
- Të hulumtojë qasjen e qytetarëve ndaj punës së institucioneve shtetërore, si dhe rolin e partive politike dhe shoqërisë civile;
- Të shqyrtojë pikëpamjet e qytetarëve përsa i përket barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në politikë;
- Të nxisë qytetarët të japin rekomandime për partitë politike, organizatat e shoqërisë civile si dhe qeverinë.



Shpërndarja e grupeve të diskutimit



Metodologjia

- Periudha e punës në terren: 1 - 6 dhjetor, 2014. Vazhdimi i hulumtimit vjetor nëpërmjet grupeve të fokusuara, të zhvilluar në tetor 2012 dhe dhjetor 2013.
- 10 Grupe të Fokusuara në: Shkodër (2), Tiranë (2), Fier (2), Elbasan (2), dhe Korçë (2). Qytetet u përzgjedhën në bazë të popullsisë, madhësisë, si dhe pozicionit gjeografik.
- Pjesëmarrësit në secilin prej qyteteve, u përzgjedhën në mënyrë rastësore duke përdorur procedurat e rekrutimit dhe të përzgjedhjes paraprake për të garantuar diversitet demografik në gjini, moshë, vendndodhje urbane/rurale, nivel të ardhurash dhe status punësimi.
- Hulumtimi përmes Grupeve të Fokusuara është cilësor, dhe jo sasior. Gjetjet janë tregues i mendimit publik por nuk reflektojnë opinionin publik në mënyrë statistikore. Gjetjet nuk mund të përgjithësohen për popullsinë në tërësi.
- Studimi u përgatit nga NDI, përfshirë këtu zhvillimin e udhëzuesit të diskutimit, të konsultuar me IDRA, partitë politike dhe partnerët në shoqërinë civile.



NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE

Profilet e Pjesëmarrësve në Grupet e Diskutimit

Nr	Mosha	Gjinia	Urban/Rural	Punësimi	Qyteti
1	18-40	Femra	Semi-Urban	I/E Punësuar/ I,E Papunë	Tiranë
2	36-65	Meshkuj	Urban	Sektori Privat	Tiranë
3	40-60	Femra	Urban	Pensionist/ I Punësuar	Shkodër
4	22-40	Meshkuj	Rural	I papunë/Privat I papunë, Të rinj/ I punësuar, Privat	Shkodër
5	18-40	Femra	Semi-Urban		Elbasan
6	41-65	Meshkuj	Urban	I punësuar	Elbasan
7	40-65	Femra	Semi-Urban	I Papunë/ Privat	Fier
8	22-40	Meshkuj	Urban	Privat/Publik	Fier
9	18-40	Femra	Semi-Urban	Të Rinj/ Të punësuar në institucione publik Të papunë/ Privat	Korçë
10	41-65	Meshkuj	Rural		Korçë

Përmbledhje e Raportit

- I. Pulsi publik***
 - II. Përparësitë Sociale dhe Ekonomike***
 - III. Integrimi European***
 - IV. Puna e Qeverisë***
 - V. Parlamenti dhe Partitë Politike***
 - VI. Angazhimi Qytetar***
 - VII. Qeverisja Vendore***
- 



NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE



Pulsi Publik



- Papunësia e lartë
- Ekonomia-rritja e çmimit të energjisë, rritja e tarifave në arsim, rritja e taksave për biznesin e vogël, etj;
- Përdorimi i forcës dhe selektiviteti në zbatimin e ligjit, si dhe ritmi i shpejtë i disa reformave
- Politika- mungesa e meritokracisë dhe korrupsioni i vazhdueshëm

Drejtimit i Gabuar

- Arsimi- mbyllja e universiteteve private është pozitive, por rritja e tarifave është negative
- Shëndetësia- shenja pozitive në administrimin e përgjithshëm, por problemet e vjetra me korrupsionin, mungesën e ilaçeve etj, vazhdojnë.

Pikëpamje të
Ndryshme

- Zbatimi i ligjit, përfshirë rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi nevojën për të zbatuar ligjin dhe për t'iu bindur zbatuesve të ligjit
- Prishja e ndërtimeve të paligjshme
- Iniciativa për të frenuar humbjet në energji elektrike
- Zhvillimi i infrastrukturës vendore

Drejtimit i Duhur

Puls Publik Pozitiv, por Shqetësime të Thella Ekonomike

Shumica e pjesëmarrësve besojnë se vendi përgjithësisht po ecën në drejtimin e duhur. Ata citojnë përpjekjet e bëra nga ana e qeverisë për sa i përket pagesës së faturave të energjisë elektrike dhe frenimit të vjedhjes së energjisë, prishjen e ndërtimeve të paligjshme, si dhe investimet në projekte infrastrukturore.

Të tjerë kanë këndvështrime të ndryshme ose mendojnë se vendi po ecën në drejtimin e gabuar. Papunësia dhe ekonomia e dobët, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së çmimit të energjisë dhe ushqimit, rritjes së tarifave në arsim dhe rritjes së taksave, bëjnë që një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish të besojnë se vendi po ecën në drejtimin e gabuar.

“S’mund ta them tamam se çfarë është, po ndjesia e përgjithshme është e mirë. Mendoj se jemi në fazën e fundit të tranzicionit, por çdo gjë ka nevojë për kohën e vet.” (Mashkull, Fier)

“Unë mund të them që gjërat momentalisht janë dukë shkuar në drejtimin e duhur, por koha do ta tregojnë se si do jenë në të vërtetë. ... Që një shtet të funksionojë ashtu siç duhet duhet të paguajme taksat, si në çdo vend tjetër. Po normalisht që barra bie mbi ata që janë të papunë. Rritja e çmimit të energjisë ... ka të mirat e saj, se do të mblidhen më shumë lekë që do të përdoren për investime.” (Mashkull, Shkodër)

“Unë mendoj se gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur. Unë besoj se ndërtimet e paligjshme duhet të shëmben me patjeter, edhe pse dyqanin e djalit tim e shëmbën.” (Mashkull, Tiranë)

“Taksat janë shumë më të larta, sidomos për ne që kemi biznese të vogla. Ne nuk ja dalim dot më. Taksat janë më të larta nga ç’ishin.” (Femër, Elbasan)

“Unë mendoj se rendi publik dhe prishja e ndërtimeve pa leje tregojnë se vendi po shkon në drejtimin e duhur. Ndryshime pozitive ka pasur në rendin publik. Edhe masat që janë marrë për ata që nuk paguajnë energjinë elektrike, apo masa të tjera të këtij lloji janë të mira.” (Femër, Korçë)

“Sherret politike vazhdojnë, dhe barra bie mbi ne qytetarët. Për shëmbull, për punësimin, kur ndryshohet qeveria hiqen të gjithë nga puna, edhe pastrueset. Këto janë pasojat.” (Femër, Shkodër)

Zbatim më i Mirë i Ligjit, edhe pse jo në Mënyrë të Barabartë

Pjesëmarrësit citojnë **zbatimin më të mirë të ligjit** si arsyen kryesore për perceptimin e tyre pozitiv mbi situatën aktuale në Shqipëri. Shumë përmendin një ndërgjegjësim më të madh të qytetarëve mbi nevojën për të zbatuar ligjin. Ekziston gjithashtu një perceptim i përgjithshëm se institucionet po iu përgjigjen më mirë nevojave të qytetarëve.

Në mënyrë të ngjashme, **iniciativat e qeverisë në lidhje me prishjen e ndërtimeve pa leje**, si dhe përpjekjet **për të ndaluar humbjet e energjisë elektrike**, shtojnë shumë qytetarë të besojnë se vendi po ecën në drejtimin e duhur.

Disa pjesëmarrës ngritën shqetësimin se e shohin **zbatimin e ligjit në mënyrë selektive dhe me forcë**, ku individë të pasur apo me lidhjet e duhura janë të pandëshkueshëm nga ligji, ndërkohë që qytetarët e thjeshtë dënohen edhe për shkeljet më të vogla. Ata gjithashtu thonë se pak vëmendje i është kushtuar ndikimit të këtyre reformave tek qytetarët e thjeshtë.

“Për momentin, njerëzit kanë filluar të kuptojnë se ligji është ligj, dhe po i binden..” (Mashkull, Tiranë)

“Ne nuk i dinim ligjet më përpara, prandaj nuk i respektonim. Ne ose i shkelnim, ose u shmangeshim apo bënim sikur nuk i vinim re. Tani çdo gjë filloi nga A-ja. Të gjitha vendet i respektojnë ligjet, kështu që edhe ne po fillojmë të kuptojmë që duhet të respektojmë rregullat.” (Femër, Elbasan)

“Nuk është zgjidhje e mirë nga shteti që të fus qytetarët e thjeshtë në burg. Ata janë qytetarë të thjeshtë, nuk kanë se me se të paguajnë, dhe mezi jetojnë me 3000 lek (25 USD) nga asistenca, por janë të parët që përballen me ligjin, edhe para biznesmeneve apo njerëzve të tjerë të pasur që nuk paguajnë për të [energjinë elektrike]” (Femër, Shkodër)

“Sot njerëzit janë më shumë të frikësuar nga ata që zbatojnë ligjet, se sa nga vetë ligjet” (Mashkull, Fier)

“Nuk është gjë e mirë ta bësh kaq shpejt [zbatimin e reformave]; ato duhet të bëhen më gradualisht(Mashkull, Shkodër)

“Shteti është mobilizuar dhe po bën punën e tij, po njerëzit nuk e prisnin një kthesë kaq të shpejtë. Ishim mësuar të lirë për 23 vjet, dhe kur ata përpiqen të zbatojnë ligjet në mënyrë më strikte ne ndihemi si të mbytur.” (Mashkull, Fier)

“Le të themi që e mbështesim [aksionin për prishjen e ndërtimeve të paligjshme]. Po ajo që shoh unë është se po bëhet në mënyrë selektive, duke prishur një ndërtim, dhe duke lënë një tjetër.” (Mashkull, Fier)

Vështirësitë Ekonomike Ushqejnë Ndjenja Negative

Ndërsa ekonomia së bashku me korrupsionin dhe shëndetësinë renditej mes prioriteteve kryesore në raportin e NDI-së të vitit të kaluar, këtë vit ajo qëndron shumë më lart se çështjet e tjera. **Gjendja e keqe e ekonomisë si dhe papunësia janë çështjet kryesore** për një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish të cilët e shohin vendin të ecë në drejtim të gabuar. Shqetësimet e ngritura janë mungesa e vendeve të punës- veçanërisht për të rinjtë, rritja e çmimit të energjisë dhe e produkteve të konsumit, si dhe të ardhurat e pamjaftueshme personale/familjare për të mbuluar nevojat bazë. Shumë biznese, veçanërisht të vogla dhe të mesme, pohojnë se marzhi i fitimit për to ka rënë në mënyrë të konsiderueshme për shkak të rritjes së fundit të taksave.

Pjesëmarrësit e shohin qeverinë si përgjegjëse për ekonominë e dobët dhe presin më shumë reforma, bazuar edhe në premtimet e saj zgjedhore.

“Unë bie dakord me çfarë thanë të tjerët për punësimin. Fëmijët tanë nuk kanë ku të shkojnë pasi mbarojnë shkollën. Bizneset private i marrin për ca ditë dhe pastaj i pushojnë. Nuk ka fabrika shtetërore.” (Femër, Fier)

“Punësimi ka rënë. Planet kanë ndryshuar. Ikën ata të PD-së dhe kanë ardhur ata të PS-së tani. Rendi publik është pak më mirë sipas meje. Por ekonomia jo.” (Mashkull, Korçë)

“Ajo që shoh unë është një situatë ekonomike e vështirë, që sa vjen e po shkon më keq, dhe prandaj jam pesimist për të ardhmen. (Mashkull, Tiranë)

“Papunësia është rritur shumë. Qeveria është përgjegjëse sepse nuk po krijon vende të reja pune..” (Femër, Fier)

“Ne nuk po shesim dot mallin. Nuk kemi ushqim. Ku do punojmë? Nuk ke as lekë që të çosh fëmijën në shkollë. Nuk u jep dot atë që kanë nevojë.” (Mashkull, Korçë)

“Taksat janë shumë më të larta, sidomos për ata që kanë biznese të vogla. Nuk ja dalim dot më. Taksat janë më të larta se më parë.” (Femër, Elbasan)

“Duhet të ketë zhvillim në bujqësi dhe turizëm, si dhe duhet të hapen vende pune.” (Mashkull, Shkodër)

Opinione të Ndryshme mbi Shëndetësinë dhe Arsimin

Arsimi dhe shëndetësia janë dy çështje të cilat përmenden shpesh nga qytetarët gjatë diskutimit nëse vendi po ecën në drejtimin e duhur apo të gabuar. Pjesëmarrësit janë të ndarë.

Të gjithë pjesëmarrësit duket se bien dakord se **sektori i arsimit ka nevojë për një reformë urgjente** dhe shumë pjesëmarrës përmendin si zhvillim pozitiv mbylljen e universiteteve private, të cilat shiheshin si shitës diplomash. Megjithatë, po kaq pjesëmarrës besojnë se reforma në arsim është e ngadaltë, si dhe ankohen për rritjen e tarifave të arsimit publik. Pjesëmarrësit shprehin shqetësime mbi cilësinë e përgjithshme të arsimit të ofruar në Shqipëri.

Në mënyrë të ngjashme, pjesëmarrësit vërejnë progres në shëndetësi, veçanërisht për sa i përket përmirësimit të **kushteve higjienike** në qendrat shëndetësore dhe shohin një **personel mjekësor më të gatshëm**. Megjithatë, çështjet e korrupsionit të cilat ekzistojnë prej një kohe të gjatë, si dhe **mungesa e ilaçeve dhe aparaturave mjekësore vazhdojnë të përbëjnë shqetësim**.

“Për mendimin tim, një nga gjërat që po shkon në drejtimin e gabuar është arsimi. Disa besojnë se po përmirësohet, po për mendimin tim po përkeqësohet. Tarifat për studimet master janë rritur, ndërsa kuotat [Numri i nxënësve të pranuar] janë ulur. Tani duhet të paguajmë 2 milionë lekë.” (Femër, Elbasan)

“Reforma në arsim është një gjë e mirë. [Kryeministri] mbylli ca universitete që u jepnin diplomë studentëve që nuk kishin lexuar asnjë gjë. Shumë nxënës ngelën këtë vit sepse ishin mësuar me pyetjet që nxirreshin para provimit, ndërsa këtë vit ai i ndryshoi gjërat.” (Mashkull, Tiranë)

“...Edi Rama premtoi që shkolla e lartë do ishte ose falas ose me tarifa më të ulëta. Po tani po i rrit në fakt. Kjo është gjë e gabuar. Gjithashtu më parë kishte dhe programe part-time, kurse tani po mbyllen. Pse?” (Mashkull, Fier)

“Për Fierin do të doja të ngrija çështjen e spitaleve. Unë mendoj se është bërë një punë e mirë që kur ka ardhur drejtori i ri. Shkova në spital para disa javësh dhe ngela shumë e kënaqur, duke filluar që nga ambulanca që erdhi për 5 minuta, deri tek shërbimi i mirë që mora. Më përpara as nuk të preknin më dorë po mos ta fusje dorën në xhep ndërsa tani nuk ndodh kjo.” (Femër, Fier)

“[Çfarë po shkon në drejtimin e gabuar?] Shëndetësia. Janë bërë shumë premtime, edhe për shëndetësinë falas. Thanë që s’do kishte më mungesë ilaçesh, po kjo akoma është problem.” (Femër, Korçë)

“Nuk ka ndryshim në shëndetësi. Thanë që legalizimet do ishin falas, që çmimi i energjisë do ulej. [Kryeministri] nuk mbajti asnjë nga këto premtime. Prandaj po them që asgjë e rëndësishme nuk ka ndryshuar” (Mashkull, Korçë)

Përmbajtja e Raportit

I. Puls i Publik

II. Përparësitë Sociale dhe Ekonomike

III. Integrimi European

IV. Puna e Qeverisë

V. Parlamenti dhe Partitë Politike

VI. Angazhimi Qytetar

VII. Qeverisja Vendore

Papunësia dhe Kostoja e Jetesës Kryesojnë Listën e Shqetësimeve

Ekonomia është shqetësimi kryesor i pjesëmarrësve të grupeve të fokusuara këtë vit. Shumica beson se gjendja ekonomike në vend është shumë problematike. Shumica e tyre shohin **papunësinë si sfidën kryesore.**

Të ardhurat mesatare konsiderohen përgjithësisht si të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat mujore bazë (ushqim, drita, ujë), dhe shpesh venë prindërit në vështirësi në kujdesjen për familjet e tyre, përfshirë këtu përballimin e arsimit të duhur për fëmijët.

Disa pjesëmarrës besojnë se nëse burimet publike do të administroheshin në mënyrën e duhur, ekonomia ka vend për rritje.

Disa pjesëmarrës gjithashtu shprehën shqetësimin e tyre mbi **rritjen e hendekut mes të pasurve dhe të varfërve.**

“Unë jam e martuar. Si burri edhe unë jemi të papunë. Unë jam 25 vjeçe dhe ai është 28 vjeç. Çdo ditë po bëhet më keq, dhe ne të dy jemi me shkollë, por vetëm presim. Kështu që situata është më keq se një vit më parë.” (Femër, Elbasan)

“Ekonomia është më keq. Ne kishim shumë shpresa, por çmimi i energjisë dhe ushqimit është rritur, ashtu si edhe punësimi. Ne nuk do mund ti paguajmë dot.” (Femër, Korçë)

“Unë besoj se pabarazia është një problem i madh. Ka një diferencë të madhe midis shtresave sociale në Shqipëri për sa i përket të ardhurave..” (Femër, Tiranë)

“Ka shumë probleme. Siç është rënia e konsumit, problem në investime, si ato të huaja po edhe ato lokale, investimet qeveritare, shpenzimet qeveritare dhe problem me importin dhe eksportin. Të gjitha këto të çojnë në një PBB që nuk është atje ku duhet të ishte. Ekonomia shqiptare ka potencial për të performuar të paktën me 20% më shumë se tani.” (Mashkull, Fier)

“Papunësia dhe pagat e ulëta janë problem. Jam përpjekur të gjej një punë kur erdha këtu po është e pamundur; duhet të njohësh njerëz.” (Femër, Korçë)

“Ndryshimi midis shtresës së mesme dhe asaj të ulët po rritet. Papunësia është një shqetësim shumë i madh. Për shembull, është shumë e vështirë për ata që kanë një diplomë në shkencat social për të gjetur një punë në administratën publike. Për mua më mirë të punësohesha në sektorin privat, sepse e di që do të fitoja më shumë përvojë.” (Femër, Tiranë)

“Ka probleme me menaxhimin në nivele të ndryshme. Ka probleme të mëdha për sa i përket ekonomisë dhe shëndetësisë. Në 2014, kushdo është ekonomist e sheh që ekonomia është përkeqësuar. Ka përpjekje për të kaluar krizën, por po bëhen në mënyrë partizane. Këto përpjekje nuk ndërmerren nga njerëzit e duhur.” (Mashkull, Fier)

Kërkesa për Rol më të Fortë të Shtetit në Ekonomi

Papunësia, pasiguria në punë dhe pagat e ulëta ngrihen nga pothuajse të gjithë pjesëmarrësit si shqetësime të mëdha dhe theksohet se përpjekjet nga ana e qeverisë janë të pamjaftueshme. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve i japin qeverisë përgjegjësinë kryesore për mbështetjen e punësimit në sektorin publik dhe nxitjen e punësimit në sektorin privat.

- **Shumë prej pjesëmarrësve mendojnë se qeveria duhet të hapë fabrika** në komunitetet e tyre për të garantuar rritjen e punësimit, sidomos për gratë dhe të rinjtë.
- Disa pjesëmarrës gjithashtu mendojnë se **qeveria duhet të ofrojë stimuj financiarë për bizneset private**, si taksa të ulëta apo kredi me interesa të ulëta, çka do ti lejonte këto biznese të punësojnë më shumë njerëz.
- Një numër i vogël pjesëmarrësish gjithashtu ankohen për **mungesën e monitorimit të kompanive private nga ana e qeverisë**, për të parandaluar abuzimin me të drejtat e punonjësve.

"[A mund të bëhet diçka për të përmirësuar situatën?] Duhet të hapen vende të reja pune. Biznesi privat në bashkëpunim me qeverinë duhet të hapë vende të reja pune për të papunët." (Femër, Elbasan)

"Ekziston frika se për shkak të krizës ekonomike mund të ketë shkurtime të vendeve të punës. Bankat po ashtu po bëjnë shkurtime dhe kjo vjen nga kriza ekonomike, jo se qeveria duhet të fajësohet për këtë." (Femër, Korçë)

"Papunësia është shumë keq. Njerëzit e kanë mendjen vetëm si të largohen nga vendi sepse nuk ka punë këtu." (Mashkull, Elbasan)

"Qeveria nuk duhet të merret me atë që është bërë më para, por duhet të fokusohet tek hapja e fabrikave dhe të krijojë mundësi të reja punësimi për të rinjtë." (Femër, Fier)

"Unë jam dakord me mbështetjen që po jep qeveria për fabrikat e këpucëve dhe të rrobave [në fabrikat e Elbasanit], sepse në këtë mënyre u jep njerëzve mundësi punësimi." (Femër, Elbasan)

"Kompanitë private të marrin në punë, vetëm që të duken mirë nëpër letra me qeverinë. Të mbajnë për një muaj dhe pastaj të pushojnë, pa të paguar as sigurimet shoqërore." (Femër, Fier)

"Nëse qeveria hap biznese, që të punësohen sa më shumë njerëz, të gjithë do jenë më mirë." (Femër, Shkodër)

"Dëgjova që është hapur një fabrike e re tani së fundmi në Elbasan, dhe u punësia rreth 250 veta. Prandaj them që kjo është zgjidhja e duhur." (Femër, Elbasan)

Rritja e Taksave/Çmimeve Ul Standardet e Jetesës

Pjesëmarrësit e shohin **qeverinë si përgjegjëse për rritjen e çmimit të ushqimeve dhe energjisë, si dhe rritjes së taksave dhe tarifave të arsimit** – shpesh duke iu referuar këtyre si premtime të pambajtura.

Pjesëmarrësit pohojnë se rritja e çmimeve, kombinuar me pagat e ulta, ka përkeqësuar kushtet e jetesës për grupet më të pambrojtura, si të papunët, pensionistët, e të tjerë.

Disa pronarë të bizneseve të vogla ankohen se të ardhurat e tyre kanë rënë si rezultat i rritjes së taksave.

“Puna e qeverisë është midis pozitives dhe negatives. Ka bërë shumë premtime por nuk i ka mbajtur ato.” (Femër, Tiranë)

“Taksat janë rritur, veçanërisht për bizneset e vogla, të cilët me zor po ja dalin. Taksat janë më të larta se më parë.” (Femër, Elbasan)

“Qeveria duhet të uli taksat dhe TVSH-në siç kishte premtuar.[gjatë fushatës elektorale të vitit 2013]” (Mashkull, Shkodër)

“Situata në Shkodër po shkon poshtë dhe shumë familje po e shohin emigrimin si të vetmen zgjidhje. Ashtu siç përmenda, fëmijët tanë po mbarojnë universitetin dhe po rrinë në shtëpi. Ne nuk kemi lekë për të paguar për punë.”(Femër, Shkodër)

“Qeveria është përgjegjëse, sepse tha se do të ulte çmimin e energjisë elektrike po në fakt e rriti atë. Ata thanë që do të ulnin taksat po i rritën ato. Ku janë premtimet që kanë bërë?” (Mashkull, Tiranë)

“Jemi me keq se vitin e kaluar, sepse pagat janë po ato, ndërsa çmimi i ujit, dritave, ushqimeve dhe rrobave janë rritur.” (Femër, Tiranë)

“Taksat janë gjithmonë në rritje. Unë jetoj me familjen dhe babai është i vetmi që punon. Ne kemi një biznes privat por nuk bëjmë aq shumë lekë sa më përpara, kryesisht për shkak të taksave të larta.” (Femër, Elbasan)

“Situata sot është më keq. Ne shpresuam se do të bëhej më mirë, por çmimi i energjisë është rritur, ashtu si ai i ushqimeve. Shumë shpejt nuk do t’ja dalim dot ti paguajmë. Edhe papunësia është rritur.” (Femër, Korçë)

“Duhet të hapen vende të reja pune, ashtu siç duhet mbështetje financiare për familjet në nevojë.” (Femër, Korçë)

Gratë Kërkojnë më Shumë Punësim dhe më Shumë Kontroll të Ushqimeve

Shumica e pjesëmarrësve besojnë se **ekonomia e dobët ndikon njësoj si tek femrat ashtu dhe tek meshkujt**. Një numër i vogël pjesëmarrësish, kryesisht femra, mendojnë se femrat janë ato të cilat vuajnë më shumë nga ekonomia e dobët. Edhe pse disa femra diskutojnë për sfidat me të cilat përballen për të gjetur një punë, në përgjithësi ato shpjegojnë se si ekonomia e dobët ndikon te familjet e tyre, pasi shpesh janë përgjegjëse për të menaxhuar të ardhurat familjare si dhe punët e shtëpisë, përfshirë ofrimin e ushqimit.

Për herë të parë në tre vitet gjatë të cilave NDI ka zhvilluar hulumtim përmes grupeve të fokusuara, disa pjesëmarrës, kryesisht pjesëmarrëse femra, ngritën çështjen e **sigurisë së ushqimeve si një çështje shqetësuese**. Disa pjesëmarrës përfshijnë sigurinë ushqimore mes tre prioriteteve kryesore, pasi perceptojnë një mungesë të thellë të rregullave apo kontrollit për sa i përket produkteve ushqimore.

“Të dyja palët ndikohen njësoj nga kriza ekonomike. E gjithë familja ndikohet njësoj nga kriza.” (Mashkull, Elbasan)

“[A prek kriza më shumë femrat apo meshkujt?] Më tepër femrat. Më tepër femrat sepse janë ato të cilat kujdesen për ekonominë në familje.” (Femër, Elbasan)

“Burri im shkon shpesh në Greqi, dhe unë ngelem si kryetari i familjes që menaxhon gjërat në shtëpi. Paratë që kursejmë i shpenzojmë për ushqim. Mua më duhet të merrem edhe me nevojat e fëmijëve. Vetëm një grua e di se çfarë nuk shkon në shtëpi.” (Femër, Fier)

“Gratë bëhen shtëpiake të dëshpëruara. Burrat mund të gjejnë punë më lehtë [se sa gratë], mund të punojnë si kamarier apo ndonjë gjë tjetër. Në anënt tjetër, gratë nuk mund të bëjnë çdo lloj pune.” (Femër, Korçë)

“Unë mendoj se duhet të ketë më shumë kontroll për ushqimin. Kjo është shumë e rëndësishme sepse konsumojmë produkte të pakontrolluar çdo ditë.” (Femër, Tiranë)

“Nuk është se ka shumë kontroll mbi ushqimin, dhe cilësia është e ulët. Nuk ka kontroll mbi ushqimin. Ata manipulojnë datën e skadencës.” (Femër, Fier)

“Kontrolli i ushqimit është gjithashtu një problem. Këtu nuk ka kontroll mbi ushqimin.” (Mashkull, Elbasan)

Nevojiten Subvencione në Bujqësi

Për pjesëmarrësit në zonat rurale, mungesa e infrastrukturës si dhe mungesa e subvencioneve të nevojshme për të garantuar të ardhura nga prodhimi bujqësor vijnë të jenë shqetësime të ngutshme.

Pjesëmarrësit presin që qeveria të luajë rolin e rregullatorit në treg, të ofrojë subvencione për prodhuesit vendas që përballen me importe konkurruese, si dhe të sigurojë qasje dhe infrastrukturë të tregjeve.

Nga qeveria gjithashtu pritet të administrojë më mirë importin e produkteve bujqësore në vend. Fermerët i konsiderojnë sasitë e mëdha të importeve si konkurrencë e pandershme e cila dëmton shanset e tyre për të shitur produktet vendase në treg.

“S’po e shesim më duhanin. Ishte 10.000 ALL apo 15.000 ALL Tani është 1.000-2.000. Ne që rrisim duhanin nuk nxjerrim dot as shpenzimet.(pasi ka rënë çmimi i shitjes).” (Mashkull, Shkodër)

“[Pse nuk i shisni dot produktet tuaja?] Sepse produktet që vijnë nga jashtë [të importuara]. Nuk ja vlen. Mezi mbuloj shpenzimet e prodhimit me atë që nxjerr.” (Mashkull, Korçë)

“Ka shumë për të bërë. Prodhimi vendas duhet mbështetur. Shteti duhet të ndihmojë dhe inkurajojë fermerët të punojnë në bujqësi sepse tokat janë djerrë.” (Mashkull, Elbasan)

“[Qeveria] na premtoi që do të ulte çmimin e naftës. Ty të duhen 12.000 ALL/hektar për të punuar tokën. është vështirë të marrësh kimikatet që të duhen.” (Mashkull, Korçë)

“Unë jam nga Dishnica. Rrugët tona janë si të qytetit. Ujësjetësi jonë është funksional. Njerëzit nga qytetet po vijnë dhe po ndërtojnë shtëpitë. E vetmja gjë që na nevojitet është ulja e çmimit të naftës, si dhe një treg për prodhimet. Na mungon dhe uji për vaditjen.”(Mashkull, Korçë)

“Shteti duhet të jap subvencione dhe ti jap prioritet prodhimit të brendshëm.” (Femër, Korçë)

“Nuk ka prodhim. Fushat janë braktisur, dhe të punosh tokën është bërë shumë e shtrenjtë. Kur nuk ka prodhim nuk ka treg. Shteti duhet të ndërhyjë dhe të luajë një rol rregullator në këtë aspekt.” (Mashkull, Fier)

“Për mendimin tim, shteti duhet të veprojë dhe të marrë nën kontroll këtë çështjen e çmimeve dhe të mos ja lërë tregtarëve të caktojnë çmimet e prodhimeve. Shteti duhet të bëj diçka për sherebelin. Kur erdhi kryeministri në fshat na premtoi se do të bënte diçka për çështjen e sherebelit dhe lajthive” (Mashkull, Shkodër)

Përparime në Shëndetësi edhe pse Vijon të Ketë Probleme

Në hulumtimet e mëparshme, **shëndetësia** renditet mes shqetësimeve kryesore. Megjithatë, këtë vit pjesëmarrësit **vërejnë zhvillime pozitive në këtë fushë**, kryesisht të lidhura me një nivel më të lartë të higjenes në qendrat e kujdesit shëndetësor dhe staf mjekësor më të gatshëm. Pjesëmarrësit i lidhin këto përmirësime me një perceptim të rritjes së kontrollit.

Korrupsioni mbetet një shqetësim, edhe pse disa mendojnë që është ulur. Disa pjesëmarrës besojnë se qytetarët janë vetë përgjegjës për korrupsionin. Të tjerë, besojnë se rritja e pagave për personelin mjekësor do të ndihmonte në ndalimin e korrupsionit. Pjesëmarrësit bien gjerësisht dakord se administrimi më i mirë i sistemit shëndetësor do të sillte ndryshime pozitive.

Pamjaftueshmëria e shërbimit – si mungesa e instrumenteve mjekësore, ilaçeve, ambulancave, si dhe mjekët e papërgatitur – janë shqetësimet kryesore të qytetarëve për sa i përket cilësisë së shërbimit të ofruar.

“Ka një përmirësim të cilësisë së shërbimit të ofruar në spitale. Vetëm në Elbasan janë dy skanera, që është diçka pozitive.” (Mashkull, Elbasan)

“Mungesa e ilaçeve në spitale është një gjë shumë e keqe. Ne [infermieret] shpesh na duhet tu kërkojmë pacientëve të blejnë ilaçet e tyre diku tjetër.” (Femër, Korçë)

“Unë mendoj që situata ka ndryshuar për mirë, por siç thanë dhe të tjerët përpara meje, ne i mësojmë keq [punonjësit e shëndetësisë] vetë. E bëjmë sepse mendojmë se do të bëj punë më të mirë nëse i japim diçka. Ta provojmë të mos tu japim lekë ndonjëherë, që ta kuptojnë doktorët se është detyra e tyre të na ndihmojnë.” (Femër, Elbasan)

“Unë mendoj se shëndetësia është në të njëjtat nivele, por menaxhimi i duhur është ajo që mund ta ndihmojë sektorin disi.” (Mashkull, Fier)

“Nëse shkon në një emergjencë në mes të natës, kur e gjen doktorin duke fjetur, do sillet keq me ty, edhe pse ti mund të jesh pa qejf.” (Femër, Korçë)

“Problemi me spitalet tona është se nuk ka akoma ambulanca. Nëse telefonon një ambulancë, me shumë mundësi nuk do të vijë. Mbase vijnë në qytet, por jo në fshat. Duhet të kesh një makinë private.” (Femër, Korçë)

“Nuk ka instrumente për dializë. Shumë njerëzve u nevojiten. Ne duhet të shkojmë në Greqi për ta marrë si trajtim.” (Femër, Korçë)

“Nuk ka rëndësi, nëse jam unë apo ti. Nëse nuk jep diçka (ryshfet për një punë) në arsim apo shëndetësi, do të ngeleshe në mes të rrugës. Nuk ka shanse të gjesh një punë pa dhënë ndonjë gjë.” (Femër, Tiranë)

Qeveria Duhet të Trajtojë Informalitetin

Në të gjitha grupet e diskutimit, disa pjesëmarrës ngrenë shqetësimin e tyre mbi “informalitetin”, të shprehur në formën e shkeljes së kodit të punës nga ana e bizneseve duke çuar në kushte të këqija të tregut të punës, me shumë punonjës të paregjistruar dhe shmangie të kontributeve e tatimit mbi pagë.

Ata gjithashtu besojnë se informaliteti nxit një mjedis tolerant ndaj korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin.

Pjesëmarrësit i referohen kryesisht punësimit informal, mungesës së kontrollit ndaj bizneseve për të respektuar të drejtat e punëtorëve, administrimit jo të mirë apo abuzimit me burimet publike, si dhe korrupsionit.

Ata argumentojnë se këto çështje janë endemike, dhe shkojnë përtej një mandati të vetëm qeverisës.

“Sipas meje, çështja kryesore është informaliteti që shihet kudo, duke filluar që nga lëshimi i dokumenteve [përmes lidhjeve personale dhe jo procedurave të rregullta] deri tek fakti që nga nuk ka të dhëna të sakta se sa shqiptarë jetojnë në Shqipëri. Për të rritur pagat dhe asistencën sociale shteti duhet të funksionojë siç duhet, dhe sipas meje, në këto 20 vitet e fundit nuk ka punuar.” (Mashkull, Elbasan)

“Informaliteti shihet në fabrika- të thonë që do të paguajnë sigurimet por nuk e bëjnë. Nuk do t’ia dijë njeri nëse ke pësuar një aksident apo nëse ngelesh pa punë.” (Femër, Fier)

“Sigurimet e mia shoqërore mbahen nga paga ime por nuk paguhen asnjëherë në shtet. Libreza ime e punës është bosh. Kur vijnë specialistët e tatimeve tek fabrika ime pronari u jep ryfshet dhe ata nuk kontrollojnë asnjëherë nëse ai i paguan sigurimet për punonjësit apo jo.” (Mashkull, Korçë)

“Nga vijnë problemet? Ka probleme në investimet publike që nga viti 1997 dhe ky është një problem administrimi. Këtu në Shqipëri, kur vjen një qeveri e re do ta zëvendësojë të gjithë stafin nga puna, pavarësisht nëse ata janë të trajnuar apo jo. (Mashkull, Fier)

“Unë punoj në sektorin energjetik, dhe mund t’ju garantoj se nuk është punë vjedhjesh, por korrupsioni dhe administrim i keq. Drejtorët janë të korruptuar, dhe shumica e tyre nuk paguajnë vetë faturat e dritave, dhe janë debitorë, përfshirë dhe stafin e tyre. Kështu që kjo [humbja e energjisë] lidhet me administrim.” (Mashkull, Fier)

“Një problem tjetër është kontrolli mbi ilaçet. Jashtë shtetit as nuk mund të mendosh të marrësh ilaçe pa rekomandim. Këtu është si magazinë ilaçesh.” (Mashkull, Elbasan)

Përmbajtja e Raportit

- I. Pulsi Publik*
- II. Përparësitë Sociale dhe Ekonomike*
- III. Integrimi European*
- IV. Puna e Qeverisë*
- V. Parlamenti dhe partitë politike*
- VI. Angazhimi Qytetar*
- VII. Qeverisja Vendore*

Pritshmëritë nga Integrimi European

Disavantazhet e Perceptuara

Çmime të rritura
Futja e monedhës së përbashkët (EURO)
Kriza ekonomike (Greqi, Itali, etj)

Avantazhet e Perceptuara

Standarde më të mira jetese/paga më të larta
Mundësi më të mira punësimi jashtë shtetit
Më shumë mundësi arsimimi për të rinjtë
Më shumë monitorim nga ana e BE-së mbi punën e qeverisë
Më shumë investime të huaja/ Asistencë financiare nga BE-ja

Integrimi European: Pritshmëritë Pozitive

Pjesëmarrësit ngelen përgjithësisht mbështetës të anëtarësimit në BE dhe kryesisht presin që procesi i integrimit në BE të sjellë zbatim më të mirë të ligjit, akses në tregun european të punës, mundësi arsimimi, si dhe zhvillim ekonomik.

Ashtu si në vitet e kaluara, **pjesëmarrësit presin që integrimi european të sjellë stabilitet politik dhe zbatim më të mirë të ligjit** në vend, kryesisht sepse presin një rritje të kontrollit dhe monitorimit nga institucionet europiane. Për një numër pjesëmarrësish, **anëtarësimi i plotë në BE pritet të sjellë një rritje të standardit të jetesës dhe të pagave**. Mjaft pjesëmarrës besojnë se integrimi në BE do të sjellë liri të lëvizjes dhe më shumë punësim e mundësi arsimimi, veçanërisht për të rinjtë. Disa besojnë se procesi i integrimit në BE do të sjellë më shumë subvencione për sektorin e bujqësisë.

“BE po vendos kushte për vendet që duan të bëhen kandidatë. Edhe ne përfitojmë nga kjo. Përmes statusit kandidat ne do të pranohemi në Europë. Ne do të luftojmë korrupsionin dhe informalitetin.” (Femër, Fier)

“Anëtarësimi do të sillte zhvillim ekonomik sepse ne do të kemi të njëjtat të drejta si shtetet e tjera, si Gjermania dhe Italia. Ne do të kemi punësim, paga më të larta, një sistem shëndetësor më të mirë, arsim, sistemin e drejtësisë dhe gjithë të tjerat.” (Femër, Fier)

“Integrimi European do të thotë që njerëzit do të jenë të lirë të lëvizin pa kufizimet aktuale. Nëse do të bëhemi anëtarë do të kemi të drejtën të jetojmë dhe punojmë në vendet e tjera të BE.” (Femër, Elbasan)

“Unë e konsideroj faktin që ne po shohim nga perëndim si një gjë të mirë në këto kohë. Europa ka provuar se di se si të ndërtoj një shtet dhe kjo është ajo për çfarë unë jam i interesuar. Do të doja të ndiqja këto modele. E shoh këtë proces si pozitiv.” (Mashkull, Elbasan)

“Unë mendoj se do ketë zhvillim ekonomik dhe stabilitet politik. Ja pse unë e mbështes anëtarësimin në BE.” (Femër, Tiranë)

“Normalisht, anëtarësimi në BE do të sjellë një rritje të standardeve të jetesës, sepse do të arrihen disa kritere për tu bërë anëtarë. Nëse do të ketë një rritje taksash patjetër që do të ketë dhe një rritje të ardhurash. Edhe korrupsioni do të jetë minimal.” (Mashkull, Shkodër)

“Statusi kandidat është një sukses. A e dini se sa do të përfitoj Shqipëria deri në 2020? 670 milion Euro. Është shumë.” (Mashkull, Korçë)

“Anëtarësimi në BE do të sillte mundësinë për tu fokusuar më shumë tek bujqësia dhe zhvillimi në përgjithësi.” (Mashkull, Tiranë)

Integrimi European Është një Proces i Gjatë për Arritjen e Standardeve

Ashtu si në hulumtimin e NDI vitin e kaluar, pjesëmarrësit **janë në dijeni të faktit se procesi i integritit në BE nënkupton arritjen e disa standardeve.**

Ata gjithashtu e shohin këtë si një proces ndryshimi thelbësor, afatgjatë dhe transformues.

Pjesëmarrësit i shohin standardet e BE-së **në përputhje me dëshirat e tyre** sa i përket mundësive ekonomike, standardeve më të larta të jetesës dhe trajtimit të barabartë para ligjit.

“Ka rregulla për të bërë një vend kandidat. Dhe duhet t’u përmbahesh këtyre rregullave. Duhet të arrish disa gjëra në rendin publik, uljen e papunësisë, rritjen e pagave. Nuk mund të hysh me këtë nivel rrogash.” (Femër, Korçë)

“Standardet do të jenë më të larta sepse nëse nuk i arrin kushtet për standarde të larta nuk bëhesh anëtar.” (Mashkull, Shkodër)

“Unë mendoj se është një gjë e mirë që ne po i afrohem vendeve të cilat kemi ëndërruar. Por ajo që po flasim do kohë.” (Femër, Korçë)

“Anëtarësimi do kohë, është si pema që mbjell sot vetëm për ti marrë frytet në 4 apo 5 vite.” (Mashkull, Tiranë)

“Duhet të provosh se mund të ecësh para. Nëse nuk e provon këtë, nuk mbërrin aty ku duhet. ” (Mashkull, Elbasan)

“Ti je një kandidat, por nëse nuk përmbush kriteret ata nuk do të pranojnë. Ne duhet të luftojmë korrupsionin, dhe nëse nuk e luftojmë korrupsionin si shtet, atëherë nuk na pranojnë. (Femër, Fier)

“Përgjithësisht BE favorizon tregjet e mëdha të cilat kanë potencial të lartë, por kanë dhe burime të mira njerëzore dhe natyrore, sepse kemi një popullatë relativisht të re dhe standard në arsim. Por duhet shumë punë [për të marrë anëtarësimin në BE]” (Femër, Fier)

“Për mendimin tim, të pasurit e statusit kandidat do të thotë që vendi duhet të përmbush disa standarde për tu bërë pjesë e BE. Ka shumë standarde, por më të rëndësishmet, sipas meje, janë përshtatja e kornizës ligjore dhe unifikimi i tregjeve.” (Mashkull, Fier)

Integrimi European: Disavantazhet e Mundshme

Ndryshe nga grupet e fokusuar të NDI-së në vitin 2012 dhe 2013, këtë vit, **një grup pjesëmarrësish përmendin më shumë disavantazhe të anëtarësimit në BE.**

Disa pjesëmarrës shqetësohen se anëtarësimi në BE do të sjellë rritjen e çmimeve dhe taksave, të cilat mendohet se do të ndikojnë edhe më negativisht tek gjendja e tyre financiare.

Futja e monedhës së përbashkët (EURO), e cila sipas shumë pjesëmarrësve do të bëhet sapo Shqipëria të bëhet anëtare, shihet si një nga disavantazhet më të mëdha. Ata besojnë se EURO do ta bëjë çdo gjë më të shtrenjtë, si dhe do të çojë në një krizë ekonomike, si në Italinë dhe Greqinë fqinje.

“Unë mendoj se nuk do të kemi ndonjë përfitim nga anëtarësimi në BE, nëse ngelemi me këto paga dhe këto kushte ekonomike.” (Femër, Shkodër)

“Unë në fakt jam pak e shqetësuar, sepse nëse bëhesh anëtar i BE, taksat do të jenë të njëjtat si në vendet e tjera. Unë rrallë shoh lajme, po nëse duhet të bëhemi të barabartë me anëtarët e tjerë ne nuk do të mund të mbështesim njëri tjetrin me situatën tonë aktuale ekonomike.” (Mashkull, Shkodër)

“Për mendimin tim, të qenit vend kandidat nuk do të thotë asnjë gjë. Unë mendoj se anëtarësimi në BE nuk do të sjellë asnjë gjë të mirë për Shqipërinë. është shumë shpejt për ne që të përmbushim kriteret e vendosura nga Europa. Ne nuk kemi akoma punë, as mirëqenie. Nëse synon BE do të thotë që duhet të ndryshosh monedhën tënde, dhe çfarë do të bëjnë njerëzit pastaj?” (Femër, Korçë)

“Unë jam absolutisht i sigurt që anëtarësimi në BE do të jetë një barrë më shumë për të gjithë, sepse do të na duhet të paguajmë më shumë taksa. Ne do të na duhet të paguajmë më shumë burokratë jashtë shtetit.” (Mashkull, Elbasan)

“Anëtarësimi në BE do të sjellë një ekonomi të dobët, sepse çmimet do të rriten dhe do të futet EURO.” (Femër, Korçë)

“Unë jam kundër anëtarësimit në BE. Unë e di që do më gjykoni, por merrni rastin e Italisë, e cila ka qenë një anëtare e BE-së për vite, dhe aktualisht po përpiqet të dal prej saj. Italia momentalisht ka një zhvlerësim të monedhës dhe ka kaluar shumë problem ekonomike.” (Femër, Tiranë)

Përmbajtja e Raportit

- I. Pulsi Publik*
- II. Përparësitë Sociale dhe Ekonomike*
- III. Integrimi European*
- IV. Puna e Qeverisë*
- V. Parlamenti dhe Partitë Politike*
- VI. Angazhimi Qytetar*
- VII. Qeverisja Vendore*

Puna e Qeverisë



Selektivitet në zbatimin e reformave, gjuha e frikës dhe forcës, dhe pabarazia para ligjit

Rritja e çmimit të energjisë, taksave, naftës, dhe tarifave të arsimit

Ekonomi e dobët, papunësi e lartë, dhe mungesa e një dimensionit social të reformave

Iniciativa e qeverisë për të ulur humbjen e energjisë elektrike

Prishja e ndërtimeve të paligjshme

Mbyllja e universiteteve private

Puna e Qeverisë: Njihen Disa Nisma Pozitive

Në të gjitha zonat, pavarësisht gjinisë dhe grupmoshave, pjesëmarrësit janë **përgjithësisht pozitivë kur iu kërkohet të japin një vlerësim mbi punën e qeverisë**. Shumë prej pjesëmarrësve mbështesin iniciativat e fundit të qeverisë duke i konsideruar ato si të nevojshme dhe të vonuara.

Ashtu siç është nënvizuar në seksionet e mëparshme, iniciativat e qeverisë për të ndalur humbjen e energjisë elektrike, prishja e ndërtimeve pa leje, si dhe mbyllja e universiteteve private mbështeten nga shumica e pjesëmarrësve.

Disa pjesëmarrës, përmendin si pozitive përmirësimin e rendit publik, si dhe zbatimin e ligjit kundër duhanit.

“Mendoj se shembja e ndërtimeve pa leje dhe aksioni për frenimin e humbjeve në sektorin e energjitikës janë gjëra shumë pozitive.” (Femër, Korçë)

“Më pëlqen iniciativa për reformë në sektorin energjitik. Jam gjithashtu e kënaqur me rendin publik si dhe reformën në arsim. Gjyqësori gjithashtu është në rrugën e duhur.” (Femër, Korçë)

“Mendoj se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit dhe secili duhet të paguaj borxhet e veta. Edhe pensionistët i paguajnë faturat në kohë, ndërkohë ka biznese që nuk i paguajnë.” (Femër, Fier)

“Të gjithë jetojmë në këtë vend dhe të gjithë i dimë sfidat me të cilat përballemi çdo ditë, por duhet të themi se situata nuk mund të shkonte më keq. Qeveria tregon fuqinë e vetë duke shembur ndërtimet pa leje, duke shmangur abuzimin me energjinë elektrike dhe duke mbyllur universitetet që praktikisht nuk ja vlenin fare. Universitetet do të jepnin një ‘arsim’, sa për të pasur një copë letër.” (Mashkull, Elbasan)

“Mendoj se mbyllja e universiteteve private ishte një gjë pozitive. sepse më tmerronte ideja që studentët do dilnin nga ato banka dhe nuk do dinin të shkruanin apo të flisnin shqip. Në fund fare do dilnin dhe si avokatë ose infermierë.” (Femër, Korçë)

“Ligji anti-duhan është gjithashtu diçka pozitive. Një vit para nuk hyje dot në një bar nga gjithë ai tym. Tani të gjithë kanë frikë të ndezin një cigare.” (Mashkull, Elbasan)

“Pjesa e shembjes së ndërtimeve pa leje është gjithashtu diçka e mirë sepse nuk kishte më hapësirë për të ecur nëpër trotuare.” (Femër, Shkodër)

“Mbështetja për arsimin profesional është gjithashtu një gjë e mirë. Jo të gjithë do të bëhen juristë dhe ekonomistë. Ka nevojë edhe për profesione të tjera. Kjo ka qenë në të kaluarën por qeveria aktuale i ka dhënë më shumë prioritet.” (Femër, Elbasan)

Nevojitet më Shumë Transparencë dhe Trajtim i Barabartë

Disa pjesëmarrës janë **skeptikë në lidhje me aksionet e qeverisë për prishjen e ndërtimeve pa leje si dhe ndalimin e vjedhjes së energjisë**. Ata shohin standarde të dyfishta në përzgjedhjen e rasteve për zbatimin e këtyre nismave qeveritare, dhe i shohin autoritetet ligjzbatuese të prirura për të marrë ryshfet apo për të marrë parasysh përkatësinë politike në vendimet e tyre.

Një numër pjesëmarrësish pretendojnë se iniciativa për të ulur humbjet e energjisë ka si shënjestër qytetarët e thjeshtë dhe të varfrit në veçanti, dhe jo bizneset apo elitën.

Të tjerët nuk bien dakord me qasjen e qeverisë ndaj këtyre iniciativave, të cilat i konsiderojnë si kërcënuese përmes përdorimit të forcës dhe frikës.

Ka një perceptim të një mungese vëmendjeje nga ana e qeverisë, ndaj ndikimit të pabarabartë që ndërprerja e energjisë dhe prishja e banesave ka mbi grupet e dobëta të shoqërisë.

“Mendoj se performanca [e qeverisë] është pozitive, po do ishte më pozitive akoma nëse të gjithë do shiheshin si të barabartë para ligjit. Edhe sepse ka pasur ndryshime, mendoj se në Shkodër jo të gjithë janë të barabartë para ligjit. Ata që mbështesin PS janë më të privilegjuar.” (Mashkull, Shkodër)

“Më pëlqen ideja që ligji po zbatohet, po nuk më pëlqen ideja e standardeve të dyfishta. Nëse unë mbështes të djathtën, ata do abuzojnë me pushtetin dhe do ofrojnë privilegje për mbështetësit e së majtës.” (Mashkull, Korçë)

“Nuk e mbështes prishjen e ndërtimeve pa leje. Prishin dhjetë ndërtesa dhe lënë dy, unë di për raste specifike ku janë pranuar ryshfete. Dikur e mbështesja prishjen e ndërtimeve pa leje por nuk më pëlqen ky lloj diferencimi.” (Mashkull, Elbasan)

“Jam vetëm pjesërisht dakord me të parin e performancës së qeverisë si pozitive. Filloi me procesin e akreditimit për disa universitete. Disa u mbyllën dhe u rihapën. Disa nga ato që kishin reputacion të keq, ndërruan emrin në diçka tjetër dhe u hapën sërish.” (Mashkull, Fier)

“Në parim jemi dakord me iniciativën kundër atyre që vjedhin energjinë elektrike, por nuk jemi dakord me rritjen e çmimit të energjisë. Nëse këta njerëz nuk do kishin vjedhur, do kishte më shumë të ardhura për qeverinë dhe rrjedhimisht nuk do rritej çmimi. Humbjet e mëdha kanë çuar në rritjen e çmimit.” (Femër, Shkodër)

“Jam dakord me prishjen e ndërtimeve pa leje, po jo në këtë formë, sepse ka familje që këto biznese janë e vetmja e ardhur që kanë. Për mua kjo nuk është e drejtë dhe duhet të ekzistonte një plan prishje më i saktë.” (Femër, Tiranë)

Reforma në Qeverisjen Vendore Përgjithësisht e Mirëpritur

Shumë pjesëmarrës e mbështesin Reformën e re Territoriale Administrative, që redukton numrin e bashkive në vend nga 373 në 61. Ata e shohin reformën **si diçka që do të kufizojë shpenzimet e sektorit publik dhe do të ulë korrupsionin dhe keqmenaxhimin në nivel vendor.**

Megjithëse pjesëmarrësit dinë se një reformë e tillë po zbatohet, pak e njohin përmbajtjen e saj specifike. Pjesa më e madhe e informacionit që kanë është e paplotë dhe shpesh e pasaktë. Ndërsa shumica mendojnë se shërbimet e qeverisë vendore do të qëndrojnë aty ku janë, një numër i vogël pjesëmarrësish shprehin shqetësimin se shërbimet do të jenë më pak të aksesueshme.

Shumë pak pjesëmarrës ngrenë shqetësimin se reforma u zhvillua për motive partiake të përfitimeve zgjedhore.

“Shumë komuna nuk janë në gjendje të menaxhojnë popullsinë, por do të kenë më shumë mundësi për të bërë një gjë të tillë kur të jenë pjesë e një njësie më të madhe, gjithashtu dhe me një buxhet më të madh.” (Mashkull, Tiranë)

“Është diçka që duhej bërë duke qenë se kryetarët e komunave kishin filluar të ndiheshin si princa në zonat e tyre. Për mendimin tim nuk duhet të ishin më shumë se 40 njësi. Unifikimi sjell fuqi dhe të punësuarit e administratës nuk do qëndrojnë gjithë ditën duke mos bërë asgjë.” (Mashkull, Fier)

“Sipas mendimit tim, reforma ishte një ngjarje shumë e mirë. Unë jam mësues në Dajç dhe shoh të paktën 16 punonjës komune të cilët nuk bëjnë asgjë tjetër përveç se të qëndrojnë nëpër bare dhe kafe gjithë ditën. Praktikisht ata po paguhen për të mos bërë asgjë.” (Mashkull, Elbasan)

“Blendi Çuçi [Ministria e Qeverisjes Vendore] ka organizuar disa takime me komunitat dhe bashkitë në këtë zonë, po nuk kam marrë pjesë ndonjëherë në këto takime.” (Femër, Fier)

“Reforma po bëhet që shërbimet të grupohen dhe afrohen. Bashkimi i komunave ishte gjëja më e mirë që mund të bëhej.” (Femër, Fier)

“Nuk kemi mjaftueshëm informacion në lidhje me reformën administrative, por besoj se niveli i korrupsionit do ulet, sepse duke i bashkuar të gjitha do shmangen disa abuzime që ishin të zakonshme deri tani.” (Femër, Korçë)

“Komuna e Bradashes do i bashkëngjitet Elbasanit dhe do konsiderohet një lagje e tij. Mendoj se kjo do sjelli mjaftueshëm përfitime për shkak të numrit të madh të bizneseve që operojnë aty. Taksat e paguara nuk do i shkojnë komunës por bashkisë dhe rrjedhimisht kjo do sjellë më shumë investime këtu në Elbasan.” (Femër, Elbasan)

“Mendoj se kjo reformë po zhvillohet në bazë të disa kalkulimeve politike.” (Mashkull, Elbasan)

Kërkesa për Meritokraci në Administratën Publike

Pjesëmarrësit përgjithësisht kanë qëndrime **negative për sa i përket administratës publike** dhe besojnë se në këtë drejtim ka pasur pak ose aspak ndryshim. Lidhjet politike, nepotizmi, si dhe korrupsioni në emërimet, konstatohen si probleme kryesore.

Edhe pse pjesëmarrësit në studimin e NDI-së të vitit 2013 kërkuan punësim në bazë meritash në administratën publike, pjesëmarrësit në vitin 2014 nuk vënë re përmirësime dhe vënë në pikëpyetje ekzistencën e konkurrencës së ndershme dhe meritokracisë në emërimet në administratën publike.

Një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish janë skeptikë për konkurset e hapura mbi vendet e lira të punës, veçanërisht në sektorin e arsimit.

“Administrata [publike] nuk është më aq politike sa ka qenë katër vitet e fundit gjatë kohës së qeverisë së kaluar. Po në të njëjtën kohë, meritokracia nuk është bërë standard, siç u premtua gjatë fushatës.” (Mashkull, Fier)

“Administrata publike është njëlloj. Nepotizmi gjithmonë ka ekzistuar këtu, ndërkohë që një nga premtimet gjatë fushatës ishte që do hiqeshin nga puna personat e pa kualifikuar. Dhe çfarë ndodhi, ata punësuan sërish persona të pakualifikuar.” (Mashkull, Elbasan)

“Emërimet në administratën publike bëhen ende në bazë të kontributeve partiake.” (Femër, Shkodër)

“Administrata publike është pjesa më negativ. Shumica e zyrave publike kryesohen nga militantë partiak.” (Mashkull, Shkodër)

“Edhe puna e arsimit [rekrutimi i mësuesve] që parimisht do bëhej me konkurs, besoj ishte thjesht fasadë. Njerëzit që do punësohen janë të paracaktuar.” (Femër, Elbasan)

“Konkurset janë thjesht për fasade, në të vërtetë çdo gjë rrotullohet te paret dhe miqësitë.” (Mashkull, Korçë)

“Administrata publike ka nevojë për profesionistë të kualifikuar. Deri tani nuk ka qenë kështu sepse të gjithë kanë qenë militantë.” (Femër, Korçë)

“Shumë përpjekje janë bërë për të përmirësuar administratën publike, po nuk kanë qenë të suksesshme deri tani.” (Femër, Tiranë)

“Dy vjet më parë u pushova nga një punë si ekonomist në prefekturë. U hoqa nga puna brenda një ore dhe tani, me sistemin e ri nuk jam rikthyer në punë.” (Femër, Fier)

Policia Shihet Përgjithësisht si më Reaguese

Të pyetur mbi punën e policisë së shtetit, pjesëmarrësit përgjithësisht shprehin opinione pozitive. Pjesëmarrësit janë kryesisht të kënaqur me **nivelin e lartë të profesionalizmit të treguar nga oficerët e policisë në terren.**

Përfshirja e policisë së shtetit në luftën kundër drogës ka ndikuar në rritjen e besimit të pjesëmarrësve në këtë institucion.

- Shumë besojnë se ka një rritje të gatishmërisë së policisë, dhe disa pretendojnë se ka shenja për më pak abuzime dhe korrupsion në forcat e policisë.
- Numri i shtuar i policeve femra shihet gjithashtu si një zhvillim pozitiv.
- Një numër i vogël pjesëmarrësish mendojnë se ende të fortët janë të paprekshëm nga zbatimi i ligjit.

“Performanca e Policisë Shqiptare është shumë pozitive, duke nisur nga iniciativa e parë në Lazarat [fshat në jug të Shqipërisë i famshëm për prodhimin e marijuanës, i konsideruar si i paprekshëm deri ne momentin e zhvillimit të operacionit të qeverisë për shkatërrimin e laboratorëve të drogës aty].” (Femër, Fier)

“Duheshin rreth 6 vjet për të zgjidhur një vrasje dikur, kurse tani për 5 minuta i ke në pranga njerëzit.” (Mashkull, Shkodër)

“[Policia shqiptare] Kanë bërë një punë të mirë kundër drogës, aksidenteve rrugore dhe menaxhimit të trafikut.” (Femër, Fier)

“Mbështes vendimin për të pasur nga një efektiv policie për çdo lagje, që kur të shfaqet një problem ti drejtohesh atij direkt.” (Femër, Elbasan)

“Kur filluan luftën kundër drogës, ai ishte momenti që ti kujtoje që ata ishin të gatshëm për të përdorur ligjin.” (Mashkull, Shkodër)

“Sipas mendimit tim policia e shtetit ka ndryshuar dhe më pëlqen fakti që kanë rekrutuar femra, duke ndërmarrë hapat e para drejt barazisë gjinore.” (Femër, Elbasan)

“Pavarësisht gjobave të mëdha që kanë vendosur [policia rrugore], të cilat nuk mendoj se janë të drejta, mendoj se njerëzit tani janë më të kujdesshëm me policinë. Kanë krijuar rregull dhe më pëlqen rregulli. (Femër, Shkodër)

“Të ‘fortët’ vazhdojnë të qeverisin, nuk kam një makinë luksoze, por i kam të gjitha dokumentet, policia mund të kapet me diçka, por nëse kam një makinë luksoze, e cila nuk është as e imja gjërat ndryshojnë.” (Femër, Tiranë)

Anti- Korrupsioni i Lidhur me Mundësitë/Drejtësinë Ekonomike

Në ndryshim nga hulumtimi përmes grupeve të fokusuar të NDI në 2013, këtë vit, **korrupsioni nuk është në listën e shqetësimeve kryesore të pjesëmarrësve.**

Disa pjesëmarrës vërejnë se ka pasur përmirësime në luftën ndaj korrupsionit. Pjesëmarrësit shpesh janë të aftë të përmendin raste të fundit të bëra publike të zyrtarëve të akuzuar për korrupsion të raportuar në media, në kohën kur u mbajtën grupen e fokusura (dhjetor 2014). Megjithatë, **një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve vazhdon të jetë skeptik dhe ta shohë korrupsionin si të përhapur në shumë sektorë.**

Pjesëmarrësit rendisin shëndetësinë, sistemin e drejtësisë, si dhe atë arsimor si sektorët më të korruptuar. Ashtu si vitin e kaluar, korrupsioni shihet shpesh si faktor i cili u kufizon pjesëmarrësve mundësitë e punësimit.

Pjesëmarrësit besojnë se zhvillimi ekonomik dhe meritokracia në punësim dhe emërimë mund të minimizojë korrupsionin.

“Ka disa përpjekje, po nuk ka rezultate akoma. Të paktën tani të korruptuarit dërgohen para gjyqtarit. është ndryshe nga më para duke qenë se ai (ish kryeministri) ishte i fuqishëm dhe nuk i dërgonte njerëzit e vetë në gjykatë.” (Mashkull, Elbasan)

“Më duket se ka pasur disa raste korrupsioni ku persona e përfshirë janë kapur, këtu në Elbasan. Madje një drejtor arsimit u kap dhe doli në televizor ku e pamë të gjithë. Mendoj se gjërat po shkojnë mirë sepse ka pasur të paktën 2 ose 3 raste që kemi dëgjuar kohët e fundit.” (Femër, Elbasan)

“Korrupsioni është goditur fort. Shohim shpesh para gjyqit drejtues arsimor, të cilët janë dhe nga ana e tyre [mazhorancës]. Korrupsioni ka qenë prioritet.” (Mashkull, Shkodër)

“Luftën ndaj korrupsionit nuk e quajmë dot ende të suksesshme, po ka pasur vërtet përmirësime. Korrupsioni nuk mund të zhduket nëse nuk rritet standardi i jetesës. Ekziston një thënie... problemet pjellin korrupsionin, e mbajnë gjallë dhe korrupsioni vdes kur nuk ka më probleme.” (Mashkull, Elbasan)

“Mungesa e ndonjë ndryshimi thelbësor në luftën ndaj korrupsionit. Më sa dëgjojmë ka shumë korrupsion në gjyqësor. Edhe në shëndetësi thonë që është njëlloj.” (Femër, Shkodër)

“Qeveria teorikisht ka filluar luftën kundër korrupsionit, ndërsa në sensin praktik ka dhe ulje-ngritjet e veta.” (Mashkull, Tiranë)

“Nuk e besoj diçka të tillë [që qeveria po bën një punë të mirë në luftën ndaj korrupsionit]. Edhe kur mendon për konkurset në fushën e edukimit, mendoj se janë të rreme. Mendoj se njerëzit që do punësohen janë përzgjedhur paraprakisht.” (Femër, Elbasan)

Gjyqësori Shihet si i Korruptuar dhe Jo i Pavarur

Shumica e pjesëmarrësve mbështesin **reformimin e sistemit të drejtësisë**. Pjesëmarrësit besojnë se ky sistem është i njollosur nga korrupsioni dhe ndikimi politik.

Pjesëmarrësit presin që reforma të rrisë pavarësinë e sistemit të drejtësisë nga ndikimi i politikës, të rrisë besimin e publikut te institucionet shtetërore, të luftojë kriminalitetin dhe të çojë në barazinë para ligjit.

Disa pjesëmarrës venë në dyshim bërjen e kësaj reforme së shpejti, si pasojë e përplasjeve për interesa të ndryshme politike.

Të tjerë, kryesisht e shohin reformën thjesht si një përpjekje për të zëvendësuar gjykatësit kur ndryshon pushteti.

“Sistemi gjyqësor është më i korruptuari, gjithë sektorët e tjerë janë thjesht pasoja të tij. Nëse gjykatësit do bënin një punë të mirë, pjesa tjetër nuk do korruptohej.” (Mashkull, Elbasan)

“Ne presim që gjyqësori të jetë i pavarur nga qeveria. Pastaj do të mund të themi që kemi një shtet të mirë.” (Mashkull, Elbasan)

“Ekzistojnë iniciativa për reforma në gjyqësor, por ato [partitë politike] po hasin shumë probleme për të arritur një mirëkuptim reciprok.” (Femër, Fier)

“Kanë thënë që do ketë reforma gjithandej, kështu që patjetër do ketë reformë dhe në gjyqësor. Disa gjykatës do zëvendësohen nga disa të tjerë.” (Femër, Shkodër)

“[Çfarë do të thotë reforma në gjyqësor për ju?] Nëse troket në një derë mbas reformës, ti e di që edhe nëse jo 100% të paktën në 70% të rasteve dikush do të ndihmojë, edhe sepse unë jam një qytetar i thjeshtë. Ndërsa sot, gjeja e parë që të vjen në mendje është se sa para do të kërkojnë.” (Femër, Tiranë)

“Reforma në gjyqësor do sjelli me shumë siguri, sepse ligji do zbatohet.” (Femër, Shkodër)

“Kemi dëgjuar disa gjëra për një reformë të mundshme në gjyqësor, po është shumë e vështirë që kjo instancë të bëhet e pavarur në Shqipëri.” (Mashkull, Elbasan)

“[Në çfarë duhet të fokusohet reforma në gjyqësor?] Kjo reformë duhet të zëvendësojë gjyqtarët e vjetër më gjyqtarë të rinj.” (Femër, Fier)

Përmbajtja e Raportit

- I. Pulsi Publik*
- II. Përparësitë Sociale dhe Ekonomike*
- III. Integrimi European*
- IV. Puna e Qeverisë*
- V. Parlamenti dhe Partitë Politike*
- VI. Angazhimi Qytetar*
- VII. Qeverisja Vendore*

Parlamenti: Me Shumë Baltosje se sa Debat

Pjesëmarrësit, pavarësisht gjinisë dhe grupmoshave, **shprehin interes të ulët për të ndjekur diskutimet parlamentare.** Mungesa e kulturës së debatit midis anëtarëve të parlamentit si dhe një ndjesi e përgjithshme zhgënjimi nga politika dhe politikanët, janë arsytet e dhëna për këtë interes të ulët.

Pjesëmarrësit janë shumë të qartë mbi mungesën e etikës në debatet parlamentare midis deputetëve nga i gjithë spektri politik. Sipas pjesëmarrësve, deputetët shpesh përdorin **fjalor fyes** dhe i fokusojnë diskutimet e tyre më shumë te aspektet personale të kundërshtarëve sesa tek trajtimi i shqetësimeve të qytetarëve dhe ofrimi i zgjidhjeve.

Pjesëmarrësit nuk e shohin parlamentin si një institucion të hapur dhe shfaqin pak interes për marrjen e informacionit parlamentar. Aktualisht shumica e pjesëmarrësve bazohen tek media si një burim informacioni për parlamentin.

“Dikur isha e interesuar dhe i ndiqja diskutimet në parlament, po tani më ka ardh në majë të hundës me ta. Vetëm sherre shikoj.” (Femër, Shkodër)

“Nuk kam ndonjë interes për parlamentin të them të drejtën. Nuk interesohem sepse shumë rrallë bëjnë ndonjë gjë për ne.” (Mashkull, Shkodër)

“Nuk i ndjek diskutimet në parlament, sepse gjithçka është bërë shumë e mërzitshme. Vetëm për njëri tjetrin flasim.” (Femër, Tiranë)

“Pjesën më të madhe të kohës ata zihen me njëri tjetrin, në vend që të merren me problemet e popullit.” (Mashkull, Shkodër)

“Deputetët duhet të jenë më etikë në komunikim si dhe të pranojnë gabimet e tyre.” (Femër, Tiranë)

“Ata [deputetët] gjithmonë zihen me njëri tjetrin. është turp ti dëgjosh.” (Femër, Korçë)

“Deputetët merrem me njëri tjetrin, deri në pikën ku nuk bashkëpunojnë më për të mirën e popullit. E vetmja gjë që bëjnë është të flasim për familjet e njëri tjetrit, gjë për të cilën ne nuk jemi aspak të interesuar për të dëgjuar.” (Femër, Tiranë)

“Problemi është që jo të gjithë janë të qartë në lidhje me vendet ku mund të kërkojnë për informacion në parlament. Shumica nuk janë as të informuar, as të interesuar.” (Femër, Elbasan)

“[Në çfarë lloj informacion do të donit të kishit akses?] Ligjet e aprovuara. Ato gjenden në fletoren zyrtare, por duhet të shkosh për të parë nga afër, nëse dëshiron të jesh i informuar se çfarë po ndodh.” (Mashkull, Korçë)

Parlamenti: Deputetët, Mungesë Kontakti me Qytetarët

Shumë prej pjesëmarrësve thonë se **është e vështirë të takosh deputetët jashtë kohës së fushatave zgjedhore**. Disa pjesëmarrës shprehën shqetësimin për mungesën e zyrave të përfaqësuesve të tyre, duke e konsideruar si një problem për kontaktimin e deputetëve. Shumë pjesëmarrës nuk dinë si të kontaktojnë me deputetin e zonës.

Në mënyrë të ngjashme me gjetjet e grupeve të fokusuar në vitin 2013, disa pjesëmarrës shprehen të shqetësuar mbi sistemin zgjedhor me listat e mbyllura të partive dhe sugjerojnë se do të **preferonin një sistem i cili do t'i lejonte ata të votonin për kandidatë specifikë**, sipas të ashtuquajturit sistem me lista të hapura.

"[Çfarë pritshmërie keni nga një deputet?] Ai/Ajo duhet të mbajë kontakte me elektoratin e vetë." (Mashkull, Elbasan)

"Nuk e di ku janë zyrat e deputetit të zonës time që të shkoj dhe të ankojem aty." (Mashkull, Tiranë)

"Deputetët shfaqen vetëm gjatë fushatës, marrin votat dhe pastaj nuk i sheh më." (Femër, Elbasan)

"Kontakti me deputetet është i vështirë. Është ë pamundur ti takosh, përveç se kur janë në opozitë." (Femër, Shkodër)

"Deputetet të japin numrin e telefonit, por ama nëse i merr asnjëherë nuk përgjigjen." (Femër, Elbasan)

"Duhet te vijnë dhe të mbajnë lidhje me elektoratin e tyre, por ata asnjëherë nuk shfaqen për të folur për problemet e komunitetit." (Mashkull, Elbasan)

"Është shumë e vështirë ti takosh [deputetet]. Kjo ndodh vetëm gjatë fushatës. Nuk dimë as zyrat ku i kanë." (Femër, Shkodër)

"I takojmë [deputetet] vetëm gjatë fushatës zgjedhore." (Mashkull, Korçë)

"Sipas mendimit tim, vetëm njerëzit e duhur duhet të jenë në parlament. Nuk më pëlqen se si deputetet përzgjidhen nga partia." (Femër, Fier)

"Duhet bërë me ligj dhe në kushtetutë që listat duhet të jenë të hapura, sepse në parlament kemi vetëm njerëz të zgjedhur nga kryetarët e partive." (Mashkull, Elbasan)

Gratë në Parlament Shihen si Produktive

Puna e grave deputete shihet përgjithësisht si më pozitive se ajo e kolegëve e tyre meshkuj. Ekziston një perceptim i përgjithshëm mes pjesëmarrësve se deputetet femra janë më aktive, si dhe më të artikuluar kur ngrenë çështje gjatë seancave parlamentare.

Ndërsa **shumë pjesëmarrës janë në dijeni të ekzistencës së Aleancës së Grave Deputete-** një bashkim i grave në Kuvendin e Shqipërisë - në krahasim me gjetjet e NDI në 2013, ata ishin **më pak në dijeni të aktiviteteve të kësaj Aleance,** çka mund të shpjegohet me bojkotin e parlamentit nga ana e opozitës. Ideja e të pasurit të një Aleance të tillë mbështetet gjerësisht nga pjesëmarrësit për shkak se shihet si një mekanizëm për të përmirësuar komunikimin ndërmjet partive politike të kaheve të kundërta.

“Mendoj se femrat në parlament janë shumë aktive, mbase sepse janë dhe më pak. Nëse numri i femrave ishte i njëjtë me atë të meshkujve mbase nuk do e kishim vënë re diçka të tillë.” (Mashkull, Korçë)

“Mendoj se femrat janë aktive në parlament. Jemi mësuar gjithmonë me meshkuj në parlament, tani kemi dhe femra, janë më pak në numër, po personalisht më pëlqejnë.” (Femër, Shkodër)

“Femrat i qetësojnë situatat. Nëse dy femra debatojnë më njëra tjetrën, debati nuk do jetë aq i nxehtë.” (Mashkull, Elbasan)

“[Keni dëgjuar ndonjëherë për aleancën e Grave Deputete?] Me aq sa di unë kjo, kjo lidhet me çështje feministe, dhunën se çfarë nuk duhet bërë. Ka femra edhe nga PD edhe nga PS. është një gjë e mirë.” (Mashkull, Korçë)

“Vitin e kaluar u mbledhën në sheshin qendror, këtë vit u mbledhën në lidhje me ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit.” (Femër, Shkodër)

“[Keni dëgjuar ndonjëherë për aleancën e Grave Deputete?] Ka gra deputete nga dy dyja krahët. Mesila Doda është kryetarja e kësaj aleance.” (Mashkull, Elbasan)

“Duhet të jenë më të organizuara dhe duhet të organizojnë sa më shumë aktivitete të jetë e mundur.” (Femër, Fier)

“Sipas mendimit tim [Aleanca e Grave Deputete] është diçka e mire, sepse është mirë që të ketë më shumë komunikim midis palëve.” (Mashkull, Elbasan)

Duhen më Shumë Gra në Politikë

Një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish, si burra ashtu edhe gra, **kërkojnë më tepër gra në politikë**. Ata e vlerësojnë rritjen e numrit të grave në parlament dhe në qeveri dhe **i shohin gratë si më të gatshme për t'ju përgjigjur kërkesave të qytetarëve**, më punëtore, si dhe më këmbëngulëse në trajtimin e çështjeve të rëndësishme, krahasuar me deputetët meshkuj.

Politikanet femra shpesh perceptohen si më të mira në nxitjen e dialogut në parlament, si dhe më të afta për të pasur diskutime konstruktive krahasuar me kolegët meshkuj.

Megjithëse shumica e pjesëmarrësve **nuk e shohin gjininë si faktor ndikues për zgjedhjen e tyre në ditën e votimit**, ata nuk e shohin gjininë as si pengesë.

“Mendoj se duhet të ketë më shumë femra në parlament... Femrat janë më etike se meshkujt.” (Mashkull, Elbasan)

“Femrat janë të sinqerta dhe të drejtpërdrejta, nuk bëjnë kompromise. Në sjellje si dhe elokuencë femrat janë më superiore se meshkujt.” (Femër, Fier)

“Mendoj se femrat duhet të jenë në parlament. Është një gjë shumë e mirë. Duhet të jenë të fuqishme si Angela Merkel. (Mashkull, Korçë)

“Deputetet femra janë më afër popullit. Tregojnë më shumë devotshmëri gjatë punës së tyre në terren.” (Femër, Elbasan)

“Deputetet femra bëjnë një punë më të mirë. Janë më të qeta dhe përdorin fjalor më të përshtatshëm.” (Mashkull, Korçë)

“Mendoj se femrat ministre janë më të përgatitura dhe më të suksesshme. Është gjë e mirë që është rritur numri i femrave ministre. Tani duhet parë rezultati.” (Femër, Tiranë)

“Do preferoja një femër si kryetare bashkie, sepse femra janë nga natyra më të organizuara. Në përgjithësi kam një mendim shumë pozitiv për femrat.” (Femër, Fier)

“Është e rëndësishme të kemi një femër për kryetare bashkie, sepse femrat punojnë më shumë.” (Femër, Tiranë)

“Njoh disa nga femrat pjesëtare të këshillit vendor. Janë vërtet të afta dhe serioze në punën e tyre. Femrat janë më të ndershme, të qeta dhe të afta në komunikim.” (Femër, Fier)

Partitë Politike: Duhet Veprime, jo Premtime

Njësoj si në hulumtimin me grupet e fokusuara që NDI zhvilloi në vitin 2013, **pjesëmarrësit shprehën për “mbajtjen e premtimeve” si një nga pritshmëritë më të mëdha të tyre për partitë politike** dhe janë të zhgënjyer që partitë shpesh nuk arrijnë ti mbajnë ato. Zhgënjimi i pjesëmarrësve nga negativiteti i klimës së përgjithshme politike dhe mungesa e besimit tek partitë dhe drejtuesit politikë – janë në linjën e gjetjeve të hulumtimeve të dy viteve të fundit.

Disa pjesëmarrës presin që partitë politike të kenë një platformë të qartë elektorale që trajton shqetësimet kryesore të qytetarëve, të cilat kryesisht lidhen me ekonominë dhe punësimin.

“Partitë politike duhet të mbajnë premtimet që na bëjnë kur na marrin votat. Të paktën disa.” (Mashkull, Shkodër)

“Unë votoj për partinë që bën premtimet më të mira. Pastaj shpresoj që t’i mbajnë (Mashkull, Korçë)

“Partitë politike duhet ti mbajnë premtimet dhe të jenë në kontakt të afërt me njerëzit, jo të duken vetëm gjatë fushatave.” (Femër, Fier)

“Për të fituar besimin tim, një parti politike duhet të mbajë premtimet e bëra gjatë fushatës (Mashkull, Tiranë)

“Çdo parti duhet të ketë platformën e vet dhe kur vjen fushata të paraqesë një plan të mirë ekonomik, jo diçka vetëm sa për t’u dukur. Duhet të deklarojë qartë se çfarë u premtonte qytetarëve si dhe afatet kohore për mbajtjen e këtyre premtimeve. Deri tani asnjë parti politike nuk e ka bërë këtë gjë.” (Mashkull, Elbasan)

“Jemi shumë të zhgënjyer me këto parti politike që nuk kanë më as një mendim të duhur për veten e tyre.” (Femër, Elbasan)

“Partia duhet të hartojë platformë shumë të qartë dhe të ketë njerëz të cilët publiku të ketë besim.” (Femër, Korçë)

“Normalisht, partitë politike duhet të kenë një platformë realiste, ku të adresohen çështjet më të rëndësishme të njerëzve. Mbi të gjitha, ta duhet të jenë realist.” (Mashkull, Fier)

Nevoja për Platforma të Zbatueshme dhe Kandidatë Cilësorë

Ndërsa **disa pjesëmarrës shprehen se zgjedhja e tyre në votime ndikohet nga bindjet politike** (mbështetja për një parti të caktuar), një kandidat apo platformë zgjedhore e caktuar, **një numër pjesëmarrësish rendisin interesat familjare dhe personale si vendimtare në dhënien e votës së tyre.**

Në mënyrë të ngjashme me gjetjet e vitit të kaluar, disa **pjesëmarrës nuk aprovojnë shërbimin e disa partive politike, de facto si agjenci punësimi** - për të garantuar punësim në këmbim të votës dhe mbështetjes politike.

Shumë prej pjesëmarrësve vazhdojnë ti konsiderojnë partitë politike si burimin më efikas të punësimit për mbështetësit dhe familjarët e tyre, apo si mjet të garantimit të pozicioneve të punës dhe përfitimeve të tjera materiale për qytetarët.

“Para zgjedhjeve, kandidati nga një prej partive me kontaktoi dhe me ofroj një vend pune. Sigurisht që votova për të.” (Femër, Elbasan)

“[Do votoja për një parti që përfaqëson] interesat e popullit, ndërkohë ata [partitë politike] nuk i mbajnë dot premtimet elektorale për aq gjatë sa shumica prej tyre paguajnë për të marrë votën.” (Mashkull, Shkodër)

“Para se të votoj, diskutojmë një herë me prindërit dhe votojmë për partinë që mund ti sjelli më shumë përfitime familjes, për një partitë që do na dëmtojë biznesin.” (Femër, Elbasan)

“Sipas mendimit tim, nëse një parti sjell përmirësime në fushën e punësimit, spitaleve, edukimit etj. Kërkesat e mija përmbushen dhe unë votoj për atë parti.” (Mashkull, Elbasan)

“[Çfarë influencon në zgjedhjen tuaj, gjatë zgjedhjeve?] Siguria që njerëzit do punësohen.” (Mashkull, Elbasan)

“Gjithmonë votoj për kandidatin, pavarësisht nëse më pëlqen partia ose jo.” (Femër, Shkodër)

“Gjithmonë votoj bazuar në interesat e mija familjare.” (Femër, Korçë)

“Një parti duhet të mbajë premtimet, nëse dëshirojnë që unë të votoj serish për ata në zgjedhjet e ardhshme.” (Femër, Fier)

“Partitë politike këtu janë thjesht agjenci punësimi dhe s’kanë të bëjnë fare me politikën.” (Mashkull, Elbasan)

“[Çfarë influencon në zgjedhjen tuaj, gjatë zgjedhjeve?] [...] të fitoj një vend pune. Shoh se çfarë përfitimesh personale mund të kem në të ardhme.” (Femër, Elbasan)

Pikëpamje e Zyrtë për Bojkotin Parlamentar të Opozitës

Bojkoti thuhet gjysëm-viti i parlamentit, nga ana e opozitës, i cili përfundoi në dhjetor 2014, ka shkaktuar zhgënjim të thellë te pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, pavarësisht gjinisë, grupmoshës dhe shpërndarjes gjeografike.

Pjesëmarrësit besojnë se **opozita duhet të luajë rol thelbësor në vënien para përgjegjësisë të qeverisë, bashkëpunimin me qeverinë për çështjet me rëndësi për qytetarët, si dhe në paraqitjen e alternativave për legjislacionin dhe reformat** e propozuara nga qeveria.

Disa pjesëmarrës mbështesin iniciativat e opozitës kundër rritjes së tarifave për studentët. Gjithashtu iniciativa e opozitës për të denoncuar publikisht zyrtarë publikë me të shkuar kriminale përgjithësisht vlerësohet nga pjesëmarrësit.

“Bojkoti është diçka shumë e gabuar. Nuk është kjo arsyeja që ne kemi votuar për ata. Nëse votohesh si përfaqësues e një zone të caktuar, si mund të bojkotosh procesin e qeverisjes? Apo do thjesht të marrësh paratë dhe mos bësh asnjë gjë? Është vërtet interesante kur sheh seancat plenare dhe e sheh sallën bosh shumicën e kohës.” (Mashkull, Tiranë)

“Po bëjnë të njëjtën gjë si opozita e mëparshme. Qeveria e sotshme bëri po të njëjtën gjë kur ishte në opozitë.” (Femër, Elbasan)

“Mendoj se [opozita] duhet të bëjë opozitë në parlament dhe jo nëpër parqe dhe rrugë. Nuk mund të akuzosh qeverinë në fuqi për mbi një vit për diçka që ti s’ke bërë 8 vitet e fundit.” (Femër, Korçë)

“Sinqerisht nuk e di se cila është arsyeja mbrapa bojkotit. Duke mos shkuar në parlament e është e pamundur që ti dëgjohet zëri i tyre, ose zëri i njerëzve që përfaqësojnë. Një opozitë e fuqishme do e bënte dhe qeverinë shumë më të kujdesshme.” (Mashkull, Tiranë)

“Një opozitë e shëndoshë krijon një ambient më të mirë për mazhorancën. Opozita aktuale nuk po bën punën e vetë, sepse nuk po merret me performancën e qeverisë aktuale. Ulesh dhe flet për çdo sektor duke u bazuar në të dhëna konkrete dhe opozita aktuale nuk po e bën një gjë të tillë.” (Mashkull, Elbasan)

“Të kundërshtojnë vendimet e qeverisë, me të cilat nuk janë dakord në parlament. Atë duhet të bëjë opozita, në vend të protestave. Protestat duhet të jenë alternativa e fundit.” (Mashkull, Shkodër)

Interes i Ulët për t'u Angazhuar në Politikë

Pjesëmarrësit e të dyja gjinive, **shprehin interes relativisht të ulët për përfshirje në politikë**. Pjesëmarrëset femra shpesh rendisin mungesën e kohës, barrën e detyrimeve të shumta familjare e pritshmërive shoqërore, si dhe natyrën mashkullore të politikës në vend, si arsye për mospërfshirjen në politikë.

Si meshkujt, ashtu edhe pjesëmarrëset femra, gjithashtu pretendojnë se perceptimi i politikës si “një punë e pisët” i frenon për t’iu bashkuar një partie politike.

Disa pjesëmarrës gjithashtu përmendin rrezikun e humbjes së punës pas rotacioneve politike si arsye për mospërfshirjen në politikë.

Kryesisht, pjesëmarrëset femra përmendin mungesën e arsimit dhe kualifikimit si pengesa, ndërsa gratë e moshuara rendisin moshën si arsye.

“Duhet ti dedikohesh dhe të mos merresh me aktivitete të tjera. Politika të largon edhe nga familja, sepse ke shumë obligime.” (Femër, Elbasan)

“Kam dalë në pension, nuk kam as kohë, as energji për të bërë një gjë të tillë. Duhet të jesh aktivist për ta bërë, duhet të kesh kohë të lirë.” (Femër, Fier)

“Që të përfshihesh në politikë, duhet të përkushtohesh. Politika është e komplikuar. Unë nuk kam kohë.” (Femër, Fier)

“Që të bëhesh politikan duhet të jesh i aftë. Plus duhet edhe të udhëtosh shumë, unë personalisht preferoj më shumë të qëndroj me familjen time.” (Femër, Tiranë)

“Jo, sepse nuk jam njeri elastik. Jam shumë e ndershme, nuk i pranoj dot gjërat e gabuara.” (Femër, Tiranë)

“Nuk e shoh dot veten me asnjë parti. Në politikë njeriu më i suksesshëm është ai që gënjën më mirë.” (Mashkull, Shkodër)

“Kam menduar në lidhje me këtë, po jam tërhequr sepse angazhimet politike të largojnë nga angazhimet familjare. Së dyti kur je pjesë e një partie, rrezikon të mbetesh pa punë kur vjen partia tjetër.” (Femër, Shkodër)

“Nëse je në punë momentin që ndërron pushteti, do të zëvendësojnë direkt. Është më mirë të jesh neutral.” (Femër, Korçë)

“Nuk jemi të lirë, sepse politika lidhet në formë direkte me vendin tonë të punës.” (Femër, Shkodër)

Përmbajtja e Raportit

- I. Pulsi Publik*
- II. Përparësitë Sociale dhe Ekonomike*
- III. Integrimi Europian*
- IV. Puna e Qeverisë*
- V. Parlamenti dhe Partitë Politike*
- VI. **Angazhimi Qytetar***
- VII. Qeverisja Vendore*

Nivel i Ulët i Angazhimit Qytetar

Ashtu si në vitet e kaluara, pjesëmarrësit në grupet e fokusuara, **raportojnë nivele të ulëta të angazhimit qytetar**. Shumë pak thonë se angazhohen në aktivitete të cilat synojnë të ndihmojnë komunitetet e tyre, si përfshirja në iniciativa të përbashkëta për pastrim si dhe projekte të vogla infrastrukturore në lagjet e tyre.

Pjesëmarrësit përmendin mungesën e kohës, kufizimet ekonomike, si dhe mungesën e mbështetjes si pengesat kryesore për përfshirjen në komunitet.

Ka një farë dijenie rreth organizatave që ndihmojnë komunitetet në rajonet përkatëse. Disa pjesëmarrës arrijnë të përmendin disa OJQ, puna e të cilave përqendrohet tek dhënia e ndihmës për të varfërit, jetimët, komunitetin Rom, si dhe gratë. Megjithatë, në përgjithësi, pjesëmarrësit janë kryesisht të painformuar mbi prezencën e shoqërisë civile.

“Unë jam përgjegjësi i pallatit aty ku jetoj, por nuk është diçka që ma vlerëson njeri. Kur hyra për herë të parë pallati ishte me një gjendje shumë të keqe, por tani i kam rregulluar shumicën e problemeve.” (Femër, Elbasan)

“E vetmja gjë që bëjmë është që mblidhemi ndonjëherë dhe pastrojmë pallatin. Përveç kësaj nuk arrijmë të organizojmë asgjë tjetër.” (Femër, Fier)

“[A jeni aktiv në komunitet?] Po. Ku shfaqet ndonjë problem i përbashkët, mblidhemi për të gjetur një zgjidhje në kolektiv.” (Mashkull, Tiranë)

“Kanalizimet shpesh bllokohen dhe duhet të merremi vetë me këtë problem. Edhe se bashkia merret me mbeturinat, ka gjithmonë mbetje me të cilat duhet të merremi vetë.” (Femër, Fier)

“[A jeni në dijeni të ndonjë organizate në Elbasan që punon për të përmirësuar jetesën në komunitet?] Po. World Vision. Ofron ndihmë për familjet e ndodhura kryesisht në zonat rurale. Ndhmon gjithashtu dhe jetimët.” (Mashkull, Elbasan)

‘Zoja e Këshillit të Mirë’ [organizate fetare] është gjithashtu një organizatë e tillë. Edhe ata ndihmojnë.” (Mashkull, Elbasan)

“Kam qenë në kontakt me disa organizata të cilat punojnë në Elbasan. Mund të përmend Qendrën e Komunitetit Rom. Po bën një punë të mirë. Organizatat në Elbasan zakonisht e ndihmojnë komunitetin dhe qytetarët” (Femër, Elbasan)

“Asetet ekonomike janë të nevojshme që ti të përfshihesh për të ndihmuar komunitetin. Dëshira për tu përfshirë në shërbim të komunitetit do ishte më e madhe, nëse do ekzistonin mundësi më të mëdha ekonomike. Initiative jote duhet mbështetur nga dikush.” (Femër, Shkodër)

Televizioni Publik Shqiptar

Televizioni Publik Shqiptar (TVSH) rrallë gjendet mes zgjedhjeve të para për sa i përket kanaleve televizive për pjesëmarrësit. Ata e shohin TVSH si të ndikuar politikisht, dhe për rrjedhojë të paaftë për të prodhuar mbulim objektiv. Ata gjithashtu pretendojnë se ka një mungesë cilësie në program.

Megjithatë, disa pjesëmarrës mendojnë se TVSH-ja është përmirësuar disi për sa i përket cilësisë së përmbajtjes, krahasuar me vitet e kaluara.

Pjesëmarrësit e shikojnë TVSH-në kryesisht për të ndjekur ndeshjet e kombëtares shqiptare të futbollit (veçanërisht për pjesëmarrësit meshkuj), Festivalin e Këngës, si dhe disa programe lajmesh.

“[Çfarë mendimi keni për TVSH?] Jo aty ku duhet të jetë. Për aq gjatë sa është diçka publike, nuk duhet të jetë nën influencën politike. Praktikisht është inekzistent. (Mashkull, Elbasan)

“Kryesisht lajme shohim, që të jemi në gjendje të bëjmë dhe dallimin midis një kanali dhe një kanali tjetër. TVSH ka qenë shumë i anshëm dikur, tani është më mirë.” (Femër, Fier)

“TVSH-në e shohim kur luan kombëtarja, sepse e sheh ndeshjen falas.” (Mashkull, Fier)

“[E ndiqni TVSH?] Po. Vetëm për sporte. Nuk ja vlen për asgjë tjetër.” (Mashkull, Korçë)

“[Çfarë ndiqni zakonisht në TVSH?] Shohim Festivalin Kombëtar. Kryesisht gjëra që kanalet e tjera nuk japin.” (Mashkull, Korçë)

“[E ndiqni TVSH?] Ndjekim ndeshjet e kombëtares kur ndodhemi në shtëpi.” (Mashkull, Shkodër)

“[E ndiqni TVSH?] Jo shumë. Është një kanal i influencuar politikisht.” (Mashkull, Tiranë)

“TVSH reflekton partinë në pushtet. Përmbajtja e programeve rallë ja vlen.” (Femër, Tiranë)

Përmbajtja e Raportit

- I. Pulsi Publik*
- II. Përparësitë Sociale dhe Ekonomike*
- III. Integrimi European*
- IV. Puna e Qeverisë*
- V. Parlamenti dhe Partitë Politike*
- VI. Angazhimi Qytetar*
- VII. Qeverisja Vendore*

Qeverisja Vendore: Përparësitë Sociale dhe Ekonomike

Megjithëse një numër pjesëmarrësish në rajone të ndryshme, shpesh përmendin një investim në rritje në infrastrukturën vendore si një zhvillim pozitiv, ata gjithashtu ngrenë një sërë shqetësimesh të ngjashme kur flitet për punën e qeverive vendore.

Shumë pjesëmarrës, **shprehin shqetësimin e tyre mbi mungesën e investimeve të mjaftueshme në infrastrukturë, planifikimin urban problematik** (kryesisht i lidhur me ndërtimet e paligjshme), **mungesën e hapësirave të gjelbra, si dhe ndotjen mjedisore dhe keqadministrimin e mbetjeve.**

Shumë pjesëmarrës presin që qeverisja vendore të ketë një qasje më proaktive për sa i përket krijimit të mundësive për punësim, uljes së taksave, si dhe ofrimin e mbështetjes për bizneset. Në mënyrë të ngjashme, pjesëmarrësit i inkurajojnë zyrtarët vendorë që t'i kenë dyert e hapura për qytetarët.

“Sipas mendimit tim qeveria vendore bëri një punë të mirë katër vitet e para (nga dy mandatet), po kohët ë fundit nuk ka bërë më asgjë që ja vlen të përmendët.” (Femër, Elbasan)

“Gjeja më e keqe në lidhje me qeverinë vendore sipas mendimit tim është që ende nuk kanë një plan urban për qytetin.” (Femër, Elbasan)

“Krahasuar me më para, bashkia ka bërë një punë të mirë duke rikonstruktuar disa kopshte dhe shkolla. Ka ndërtuar dhe dy-tre shtëpi për pjesëtarët e komunitetit Romë. Në përgjithësi ka bërë një punë të mirë.” (Mashkull, Elbasan)

“Qeveria vendore, këtu ku unë jetoj ka bërë një punë të mirë. Kryetari i Bashkisë është Demokrat, dhe duhet të përpiqet të bëjë një punë të mirë për njerëzit e tij, pavarësisht nëse ata janë demokratë apo socialistë. Kjo gjë nuk duhet të ketë rëndësi.” (Mashkull, Shkodër)

“Shumë gjera janë përmirësuar në Shkodër. Njerëzit nuk e njohin më Shkodrën kur vijnë këtu.” (Femër, Shkodër)

“Bashkia nuk ka bërë investime, as ne shkolla ose kopshte, rruge ose kosha plehrash. Nuk e di se çfarë bëjnë me lekët tona.” (Femër, Tiranë)

“Bashkia nuk ka bërë shumë. Ka shumë rruge në një gjendje të mjeruar, sidomos nëpër lagje.” (Mashkull, Fier)

“Qyteti ka probleme me ndriçimin. Ata mbledhin taksa për ndriçim, po shumica e rrugëve janë të zhytura në errësirë.” (Femër, Korçë)

Qeverisja Vendore: Nevojë për Pjesëmarrje Qytetare

Të pyetur nëse mendojnë se kanë ndonjë ndikim në vendimet që merren nga autoritetet vendore përkatëse, shumë **pjesëmarrës nuk besojnë se kanë ndonjë ndikim në këtë proces**, megjithëse pak prej tyre kanë marrë pjesë në mbledhjet e këshillave bashkiakë.

Bisedat me miqtë dhe familjen vijnë të jenë vendi më i zakonshëm ku pjesëmarrësit shkëmbejnë pikëpamjet e tyre mbi çështjet politike dhe sociale. Kontakti i drejtpërdrejtë me zyrtarët publikë apo institucionet është i rrallë, ndërsa pjesëmarrësit i konsiderojnë përpjekjet për një kontakt të tillë si të kota, pasi besojnë se zëri i tyre nuk dëgjohej.

“Kemi vërtet përfaqësues nëpër komuna, po gjithçka është vetëm për formalitet. Askush nuk të pyet për asgjë.” (Mashkull, Korçë)

“Normal që zëri jonë nuk dëgjohej. Nëse do dëgjohej do kishte të paktën disa kosha plehrash më shumë nëpër rrugë” (Femër, Tiranë)

“Më duket e kotë të ndaj shqetësimet e mija, sepse askush nuk merr përsipër të dëgjojë se çfarë ke për të thënë.” (Mashkull, Elbasan)

“Ata [autoritetet vendore] nuk na kanë ftuar asnjëherë me ndonjë mbledhje. Nuk i intereson se çfarë ne mendojmë.” (Femër, Fier)

“Ai [kryetari i bashkisë] ka punësuar shoqërinë dhe familjarët e vetë. Kushdo që punon për qeverinë do bënte po të njëjtën gjë. Edhe unë do beja po të njëjtën gjë.” (Mashkull, Elbasan)

“Pse duhet të na dëgjohej zëri? Ata që janë në pushtet nuk i marrin asnjëherë parasysh opinionet tona” (Femër, Tiranë)

“Ata [autoritetet lokale] marrin vendime të bazuara në interesat e tyre personale. Pyesin vetëm njerëzit që kanë vërdallë dhe nëse dikush guxon të kundërpërgjigjet e pushojnë nga puna. Nuk duan të na informojnë sepse qëllimi i tyre është të organizojnë mbledhje të vogla të cilat nuk duhet të merren vesh.” (Mashkull, Shkodër)

“[Zakonisht, si e shprehni opinionin tuaj në lidhje me çështje të ndryshme sociale?] Këtë e bëj kur ulem dhe pi një kafe me shoqërinë” (Mashkull, Tiranë)

Çështjet Vendore

Ndotja mjedisore dhe menaxhimi i mbetjeve janë çështjet më të rëndësishme për pjesëmarrësit në Elbasan dhe Fier. Çështja e ndotjes mjedisore, kryesisht për arsye të ndërtimeve përgjatë lumit Gjanica, si dhe për shkak të ndotjes nga nafta, është një shqetësim i madh për pjesëmarrësit nga qyteti i Fierit.

Pjesëmarrësit në Shkodër, ngrënë shqetësimin e tyre për çështje që lidhen me sigurinë publike. Rënia e çmimit të duhanit dhe sherebelës është shqetësuese për pjesëmarrësit nga zonat rurale të Shkodrës, pasi ato janë shpesh burimi kryesor i të ardhurave. Pjesëmarrësit kërkojnë uljen e taksave për kompanitë që mbledhin sherebelë dhe duhan.

Në Korçë, fermerët shprehen se mungesa e një tregu për prodhimet e tyre bujqësore ka ndikuar negativisht në standardin e jetesës. Për shumë prej tyre, importi i produkteve (kryesisht mollëve) nga vendet fqinje ka kufizuar aftësinë e tyre për të konkurruar në treg. Ata gjithashtu ngrënë çështjen e infrastrukturës për të dalë në treg, si dhe çështjen e vaditjes dhe të subvencioneve.

“Ndotja e ajrit në Elbasan po përkeqësohet.” (Femër, Elbasan)

“Ndodhi që kam qënë pjesë e disa bisedimeve për mbledhjen e mbeturinave në Elbasan dhe mendoj se kjo është gjeja më e rëndësishme që duhet zgjidhur këtu.” (Mashkull, Elbasan)

“Gjanica ka qenë problem që prej 20 vjetësh, por asgjë nuk është bërë për ta zgjidhur problemin. Njerëzit në Fier po sëmuren çdo dita nga nafta e derdhur aty nga rafineria.” (Femër, Fier)

“Asgjë nuk është bërë për Gjanicën. Kaq shumë vite kanë kaluar dhe situata e Gjanicës është po njëjloj. Po helmohen njerëzit.” (Mashkull, Fier)

“Policia gjithashtu nuk e bën punën e vetë ashtu siç duhet. Ka shumë vjedhje shtëpish dhe vrasje.” (Femër, Shkodër)

“Ka shumë lajthi aty ku jetoj. Këtë vit ka qenë disi më mirë sepse një kompani italiane vinte dhe i blinte lajthitë ne fshat, ndërkohë që komuna vilte taksa nga ky proces. Por nëse ti i vendos këtyre kompanive një taksë të lartë transporti, kush do të vijë serish për të blerë produktin?” (Mashkull, Shkodër)

“Bujqësia po përkeqësohet. Unë jam nga Devolli. Mbi 90% e prodhimit të mollëve nuk u shit sepse nuk pati treg për ta shitur. Nuk ka kontroll doganor dhe tregjet e huaja janë të lira të bëjnë çfarë të duan.” (Mashkull, Korçë)

“Meqenëse po përmendim bujqësinë, motra imë merret me tokën, po nuk ka të ardhura. Nuk ka ku ti shesë domatet ose produktet e tjera asgjëkund. Janë njerëz punëtorë, punojnë shumë, por qeveria nuk i ndihmon aspak.” (Femër, Korçë)

Këshilla për Kandidatët për Kryetarë Bashkish

“Do i sugjeroja që të vinte më shpesh për të takuar njerëzit këtu. Kjo është forma e vetme se si unë mund ti sugjeroja dicka.” (Mashkull, Shkodër)

“Duhet të ketë një staf të ndershëm dhe profesional.” (Femër, Shkodër)

“[Çfarë do i sugjeronit kryetarit të bashkisë?] Do i sugjeroja të pastronte qytetin dhe ta bënte atë një shembull edhe për qytetet e tjera në Shqipëri. Gjithashtu të shtonte hapësirat e gjelbra në qytet.” (Mashkull, Elbasan)

“Do i sugjeroja të bënte diçka për metalurgjikun, si dhe t’ja hapte derën qytetarëve dhe ti dëgjonte shqetësimet dhe problemet. Nëse do i bënte këto gjëra, çdo gjë do ishte në rregull.” (Femër, Elbasan)

“Si fillim do i kërkoja të përmirësonte infrastrukturën e lagjeve, duke qenë se rrugët janë në gjendje shumë të keqe dhe të pisët me baltë.” (Femër, Fier)

“Duhet të krijojë vende të reja pune për rininë.” (Femër, Fier)

“Do i kërkoja të bënte diçka për makinat që kalojnë para shkollave, duke qenë se është e rrezikshme për fëmijët kur kalojnë rrugën.” (Femër, Fier)

“Do i sugjeroja të bënte diçka për qentë e rrugëve.” (Mashkull, Korçë)

“Do i kërkoja të vinte të kontrollonte fabrikën ku unë punoj, duke qenë se pronari me thotë se jam i siguar, po në të vërtetë unë nuk jam.” (Mashkull, Korçë)

Ky raport dhe hulumtim i opinionit publik i organizuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI) në Shqipëri u mundësuan me mbështetjen e Ndhmës Amerikane për Demokraci (NED). Opinionet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë këndvështrimet e NED apo të ndonjë individi të organizatave të lartpërmendura.



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

Copyright © National Democratic Institute 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pjesët e këtij punimi mund të përdoren ose të përkthehen për qëllime jofitimprurëse, ku NDI të njihet si burim i materialit dhe t'i dërgohen kopje të përkthimit.